



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**  
**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 2883 prot.

Tiranë më, 26.10.2018

**UDHËZIM I PËRGJITHSHËM**

Nr. 05, datë 26.10.2018

**PËR**

**“GARANTIMIN E ASISTENCËS NDAJ VIKTIMAVE DHE DËSHMITARËVE TË  
VEPRAVE PENALE”**

Në mbështetje të nenit 148/b, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 38, pika 2, shkronjat “b” dhe “dh”, nenit 68 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.7905, datë 23.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”,

**UDHËZOJ:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Qëllimi dhe objektivat**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të japë udhëzime që duhet të ndiqen nga prokurorët, punonjësit e policisë gjyqësore dhe punonjës të tjerë të prokurorisë gjatë ndërveprimit të tyre me viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale.
2. Ky udhëzim synon të arrijë objektivat e mëposhtme:
  - a) të nxisë një zbatim uniform të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që lidhen me viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale;

b) të përcaktojë politikat e prokurorisë në lidhje me trajtimin e viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale;

c) të ndihmojë në garantimin e të drejtave që u njihen viktimave të veprave penale dhe ofrimin e shërbimeve që u takojnë atyre me ligj;

ç) të parandalojë viktimizimin e përsëritur dhe riviktimizimin e viktimave që vijnë në kontakt me prokurorinë dhe të pakësojë ndikimin traumatizues të pjesëmarrjes në procesin penal;

d) të udhëzojë prokurorët, punonjësit e policisë gjyqësore dhe punonjës të tjerë të prokurorisë për mënyrën se si duhet t'i respektojnë detyrimet e tyre ligjore ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale.

## Neni 2

### Përkufizime

Në këtë udhëzim, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

a) *“abuzim me fëmijët”* janë veprat penale të parashikuara nga nenet 100, 101, 106, 107/a, paragrafët 2 dhe 3, 108, 108/a, paragrafi 2, 109, paragrafët 2 dhe 3, 109/c, paragrafët 3 dhe 5, 110/b, paragrafi 1, 110/c, paragrafi 2, 114, paragrafi 2, 117, 124, 124/b, 125, 127, 128/b, 129, 130 dhe 130/a të Kodit Penal;

b) *“abuzim seksual”* janë veprat penale të parashikuara nga nenet 100 deri 106, 107/a, , 108, 108/a, 110/a, 110/b, 114, 117 dhe 130/a të Kodit Penal;

c) *“dhunë në familje”* ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”<sup>1</sup>;

ç) *“fëmijë”* dhe *“i mitur”* kanë të njëjtin kuptim, atë të personit që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç;

d) *“grup teknik ndërsektorial”* ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”<sup>2</sup>;

dh) *“interes më i lartë i fëmijës”* ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”<sup>3</sup>;

e) *“koordinator i viktimave”* ose *“koordinator”* është punonjësi i sektorit të asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm, i ngarkuar me detyrën për t’u ofruar shërbime dhe mundësuar ushtrimin e të drejtave nga ana e viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale;

ë) *“person me paafësi fizike apo intelektuale”* është personi që nuk është i aftë të ndërveprojë me personelin për marrjen e shërbimeve, si pasojë e një dëmtimi konjitiv ose

<sup>1</sup> Çdo veprim apo mosveprim, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.

<sup>2</sup> Grupi teknik ndërsektorial i trajtimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës.

<sup>3</sup> E drejta e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror, social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për të.

kufizimi fizik. Për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, nuk është kusht që personit të paaftë t'i jetë hequr zotësia për të vepruar;

f) "*personel i prokurorisë*" është çdo punonjës i prokurorive të juridiksionit të zakonshëm, përveç prokurorit dhe punonjësit të policisë gjyqësore;

g) "*përfaqësues procedural*" ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur"<sup>4</sup>;

gj) "*përndjekje*" është vepra penale e parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal;

h) "*prokuror*" është prokurori i prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, sipas nenit 2, gërma "d" e ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë";

i) "*punonjës i policisë gjyqësore*" është personi, të cilit i njihen me ligj atributet e policisë gjyqësore, përkatësisht si oficer apo agjent, përveç hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit<sup>5</sup>;

j) "*Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës*" është struktura për mbrojtjen e të miturit në nivel vendor, sipas ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";

k) "*riviktimizim*" ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur"<sup>6</sup>;

l) "*sektor*" është çdo sektor i asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm, i krijuar pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm;

ll) "*subjekt me status të posaçëm*", në kuptim të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", është i pandehuri i mitur, viktimja e veprës penale, si dhe pjesëmarrësi në proces, në çfarëdo cilësi, i cili është mitur ose me aftësi të kufizuara fizike e intelektuale;

m) "*trafikim i qenieve njerëzore*" janë veprat penale të parashikuara nga nenet 110/a dhe 128/b të Kodit Penal;

n) "*viktimizim i përsëritur*" ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur"<sup>7</sup>.

### Neni 3

#### Zbatimi i udhëzimit

1. Ky udhëzim bazohet në të drejtat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale. Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i

<sup>4</sup> Personi i caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës dhe ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, ose fëmijës dëshmitar ose viktimë, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës.

<sup>5</sup> Sipas Ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

<sup>6</sup> Shkaktimi i dëmit të miturit viktimë e veprës penale, si pasojë e një vepre penale të re që ka lidhje me të parën.

<sup>7</sup> Gjendja kur një të mituri viktimë e veprës penale mund t'i shkaktohet dëm, si rezultat i pjesëmarrjes në procesin e drejtësisë penale.

Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë, KPP-ja); ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” (më poshtë, KDPM-ja) dhe ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” janë ligjet bazë që parashikojnë detyrimet që ka prokuroria ndaj viktimave dhe dëshmitarëve. Të drejta shtesë për viktimat dhe dëshmitarët, si dhe detyrime shtesë për prokurorinë në këtë drejtim, mund të parashikohen edhe në ligje të tjerë. Në tekstin e udhëzimit, të gjithë detyrimet që rrjedhin nga Kodi i Procedurës Penale ose nga ndonjë ligj tjetër shoqërohen me një referencë të drejtpërdrejtë tek dispozita përkatëse. Rregullat e përfshirë në udhëzim që përfaqësojnë thjesht politikën që duhet të ndiqet nga prokuroria nuk shoqërohen me referenca.

2. Udhëzimi nuk krijon për viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale të drejta shtesë, përveç atyre që janë parashikuar në KPP, KDPM dhe ligje të tjerë të zbatueshëm.

2. Udhëzimi u drejtohet të gjithë prokurorëve, punonjësve të policisë gjyqësore dhe personelit të prokurorisë, të cilët kryejnë detyra që lidhen me hetimin, ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin në gjyq dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Udhëzimi zbatohet nga të gjithë personat e mësipërm që vijnë në kontakt me viktimat dhe dëshmitarët apo kryejnë veprimtari që ndikon mbi viktimat dhe dëshmitarët, pavarësisht titullit, pozicionit, gradës apo përshkrimit të punës. Personat e mësipërm duhet të inkurajojnë edhe çdo person të jashtëm që caktohet të ushtrojë aktivitet në emër të prokurorisë (p.sh: ekspert, përkthyes, etj) që të mbajë parasysh të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve dhe detyrimet ndaj tyre, si dhe të zbatojë këtë udhëzim. Udhëzimi mund të shërbejë si model edhe për agjenci të tjera shtetërore, veçanërisht ato që kryejnë funksione të zbatimit të ligjit apo ato që kanë polici gjyqësore në përbërjen e tyre.

#### Neni 4

#### **Baza ligjore për të drejtat e viktimave**

1. Detyrimi për të njohur dhe respektuar të drejtat e viktimave, si edhe për t’u ofruar atyre asistencë buron nga aktet ligjorë të mëposhtëm:

a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

b) instrumentat e mëposhtëm ndërkombëtarë të ratifikuar nga shteti shqiptar:

i) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Romë. 4.11.1950, dhe protokollet shtesë të saj<sup>8</sup>,

ii) Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Palermo, 15.11.2000<sup>9</sup>;

iii) Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Stamboll, 11.5.2011<sup>10</sup>;

iv) Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual, Lanzarote, 25.10.2007<sup>11</sup>;

<sup>8</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, shtuar me ligjet nr. 8641, datë 13.7.2000, nr. 9264, datë 29.7.2004 dhe nr. 9453, datë 15.12.2005.

<sup>9</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002.

<sup>10</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 104/2012.

- v) Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, Nju Jork, 20.11.1989<sup>12</sup>;
  - vi) Konventa e Këshillit të Evropës për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme, Strasburg, 24.11.1983<sup>13</sup>;
  - vii) Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Varshavë, 16.5.2005<sup>14</sup>;
- c) aktet e mëposhtëm ligjorë:
- i) Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”;
  - ii) Ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;
  - iii) ligji n. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”;
  - iv) Ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
  - v) Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”;
  - vi) Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”<sup>15</sup>;
  - vii) Ligji nr. 10192, dt. 03.12. 2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjerë nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;
  - viii) Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit”;
  - ix) Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
  - x) Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
  - xi) Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;
  - xii) Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

2. Gjithashtu, duke pranuar qëllimin e Shqipërisë për integrimin sa më të plotë me vlerat e vendeve të tjera të Europës, si dhe për përafrimin e legjislacionit vendas me atë të *acquis communautaire*, aktet e mëposhtëm duhet të mbahen parasysh:

- a) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Paris, 10.12.1948;
- b) Deklarata e Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimeve dhe të abuzimit të pushtetit, 29.11.1985;
- c) Rekomandimi nr. R (87) 21 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar shteteve anëtarë, “Për asistencën ndaj viktimave dhe parandalimin e viktimizimit”;
- ç) Rekomandimi nr. R (85) 11 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar shteteve anëtarë, “Për pozitën e viktimës në kuadrin e të drejtës dhe procedurës penale”;

<sup>11</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 10 071, datë 9.2.2009.

<sup>12</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 7531 datë 11.12.1991.

<sup>13</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 9265, datë 29.7.2004.

<sup>14</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006.

<sup>15</sup> Duke filluar nga data 1 qershor 2018.



d) Direktiva 2012/29/EU, datë 25.10.2012, e Parlamentit dhe e Këshillit të Bashkimit Evropian që vendos standardet minimum për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit;

dh) Direktiva 2004/80/EC, datë 29.4.2004 e Këshillit të Bashkimit Evropian, në lidhje me kompensimin e viktimave të krimit.

#### Neni 5

### **Mbi ligjin nr. 35/2017, në përgjithësi**

Kuptimi dhe zbatimi i ligjit nr. 35/2017 duhet të mbështetet në parimet e mëposhtme:

a) respektimi i të drejtave të viktimave të veprave penale është një ndër parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale<sup>16</sup>. Ky parim nënkupton, nga njëra anë, se viktimat gëzojnë një sërë të drejtash, të parashikuara nga ky Kod dhe, nga ana tjetër, se organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre;

b) viktimat e veprës penale është subjekt me status të posaçëm në procedurën penale, pasi KPP-ja i njihet një pozicion dhe të drejta që e dallojnë në mënyrë thelbësore nga të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në proces;

c) KPP-ja i ka njohur viktimës të drejtën për të marrë pjesë në proces dhe për t'u përfaqësuar me avokat, por, megjithatë, prokurori duhet të marrë parasysh edhe mendimin e interesat e viktimës gjatë vendimmarrjes së tij në lidhje me çështjen.

#### Neni 6

### **Mbi ligjin nr. 37/2017, në përgjithësi**

Përveç sa parashikohet në nenin 5 të këtij udhëzimi, kuptimi dhe zbatimi i ligjit nr. 35/2017 duhet të mbështetet në parimet e mëposhtme:

a) respektimi i të drejtave të viktimave të mitura të veprave penale<sup>17</sup> nënkupton, nga njëra anë, se viktimat e mitur gëzojnë një sërë të drejtash, të parashikuara nga ky Kod dhe, nga ana tjetër, se organet publike duhet të parandalojnë riviktimizimin dhe viktimizimin e përsëritur të të miturit;

b) çdo vendim apo veprimtari që lidhet me viktimën e mitur duhet të mbajë parasysh interesin më të lartë të saj<sup>18</sup>. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të argumentojnë ose të jenë në gjendje të argumentojnë në çdo rast se si është siguruar respektimi i interesit më të lartë të fëmijës;

c) viktimat ose dëshmitarët e mitur gëzojnë, për aq sa është e mundur, të njëjtat të drejta të parashikuara për të pandehurin e mitur<sup>19</sup>;

<sup>16</sup> Neni 9/a i KPP-së.

<sup>17</sup> Neni 2, pikat 4 dhe 5, të KDPM-së.

<sup>18</sup> Neni 10 i KDPM-së.

<sup>19</sup> Neni 24 i KDPM-së.

ç) viktima e mitur i përfiton pa pagesë shërbimet e detyrueshme sipas legjislacionit procedural dhe atij për drejtësinë penale për të mitur<sup>20</sup>, përfshirë ndihmën ligjore dhe atë psikologjike<sup>21</sup>;

d) prokurorët, punonjësit e policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë që caktohen në çështjet penale me të pandehur apo viktima të mitura duhet të jenë trajnuar në këtë fushë<sup>22</sup>.

## Neni 7

### Autoriteti përgjegjës

Autoriteti përgjegjës për garantimin e të drejtave të viktimave gjatë fazës së hetimeve paraprake është prokuroria. Në zbatim të këtij detyrimi, prokuroria:

a) garanton drejtpërsëdrejti që viktimat të kenë mundësinë të ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtat dhe të përfitojnë asistencën që u njihet nga ligji;

b) sigurohet që policia gjyqësore ka përmbushur detyrat e saj në drejtim të viktimave të veprave penale dhe, në rast të kundërt, i delegon detyra konkrete për përmbushjen e këtyre detyrimeve ose i përmbush ato drejtpërsëdrejti;

c) udhëzon dhe drejton policinë gjyqësore në mënyrë të përgjithshme për të siguruar që të drejtat e viktimave garantohen në mënyrë të barabartë për të gjitha viktimat, për aq sa lejojnë burimet njerëzore dhe financiare të secilit institucion.

## Neni 8

### Roli i prokurorit

Gjatë fazës së hetimeve paraprake, prokurori është përgjegjës për sigurimin e kushteve për ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e viktimave dhe për ofrimin e asistencës së detyrueshme, sipas ligjit. Për ushtrimin e kësaj përgjegjësie, prokurori:

a) pas regjistrimit të procedimit në regjistrin e njoftimit të veprave penale, udhëzon punonjësit e policisë gjyqësore të ngarkuar me procedimin penal dhe sektorin e asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm të përmbushin detyrat e parashikuara nga ky udhëzim;

b) sigurohet që punonjësit e policisë gjyqësore dhe sektori i asistencës t'i kenë përmbushur këto detyra<sup>23</sup>. Në rast se prokurori konstaton se detyrat e parashikuara për punonjësit e policisë gjyqësore dhe sektorin e asistencës nuk janë përmbushur plotësisht, ai merr masa që mangësitë të korrigjohen, duke u deleguar detyra konkrete policisë gjyqësore dhe sektorit të asistencës apo duke vepruar vetë drejtpërsëdrejti<sup>24</sup>;

<sup>20</sup> Neni 23 i KDPM-së.

<sup>21</sup> Neni 20 i KDPM-së.

<sup>22</sup> Nenet 25 e vijues të KDPM-së.

<sup>23</sup> Neni 304 i KPP-së.

<sup>24</sup> Po aty.

c) sigurohet që viktima është identifikuar dhe njoftuar rregullisht. Në rast se ka të dhëna për viktima të tjera, merr masa për identifikimin dhe njoftimin e tyre, duke i deleguar veprime policisë gjyqësore ose duke vepruar vetë<sup>25</sup>;

ç) në rastet kur viktima e identifikuar u përket kategorive veçanërisht vulnerabël, prokurori bën përpjekje që viktimës t'i plotësohen nevojat e para jetike për siguri, ndihmë mjekësore, ushqim e veshmbathje dhe strehim. Për këtë qëllim, prokurori njofton shërbimet sociale dhe organizata jo qeveritare që ofrojnë shërbimet e nevojshme;

d) sigurohet që viktimave të identifikuar u është dhënë letra e të drejtave dhe që ato i kanë kuptuar këto të drejta<sup>26</sup>. Prokurori jep udhëzimet përkatëse që viktima të sqarohet për pozicionin, të drejtat dhe asistencën që i takon sipas ligjit;

d) informon dhe njofton viktimën në rastet e përcaktuara nga ligji;

dh) shqyrton dhe merr vendim për kërkesat e bëra nga viktima gjatë hetimeve paraprake, sipas KPP-së;

e) administron padinë civile, nëse ajo është paraqitur nga viktima ose përfaqësuesi/mbrojtësi i saj gjatë fazës së hetimeve paraprake<sup>27</sup> dhe, për aq sa është e mundur në rrethanat e çështjes konkrete, i jep viktimës kopje të akteve të dosjes hetimore dhe e ndihmon me mbledhjen e provave që mbështesin padinë civile në procesin penal. Në rastin e padisë civile, prokurori bashkëpunon me viktimën. Bashkëpunimi përfshin edhe kërkimin e përbashkët të vendosjes së sekuestros konservative<sup>28</sup>;

ë) mban parasysh edhe mendimin e interesat e viktimës kur merr vendime lidhur me çështjen penale dhe i vlerëson ato në harmoni me elementët e tjerë të çështjes;

f) trajnohet dhe merr njohuri të posaçme në fushën e drejtësisë penale për të miturit, nëse është caktuar anëtar i seksionit për të miturit në prokurorinë përkatëse<sup>29</sup>.

## Neni 9

### Detyrimet etike të prokurorit

1. Respektimi i të drejtave të viktimave dhe i dinjitetit të tyre njerëzor është detyrim etik i prokurorit. Ky detyrim buron nga ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"<sup>30</sup> dhe ligji nr.97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"<sup>31</sup>, duke qenë se u shërben qëllimeve të ruajtjes së nderit dhe dinjitetit të funksionit dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e prokurorisë.

2. Ky detyrim buron, gjithashtu, nga "Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve", sipas të cilave prokurorët, në çdo rast dhe rrethanë, duhet të respektojnë parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, në mbrojtje të të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme

<sup>25</sup> Neni 58, paragrafi 2, i KPP-së.

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> Neni 62, paragrafi 1, i KPP-së.

<sup>28</sup> Nenet 63 dhe 270 të KPP-së.

<sup>29</sup> Neni 29, paragrafi 1, i KDPM-së.

<sup>30</sup> Neni 4, "Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes".

<sup>31</sup> Neni 10, "Respektimi i rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale".



të të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, ashtu edhe të të dyshuarve, personave nën hetim, të pandehurve dhe të dënuarve<sup>32</sup>. Ky urdhër përmban detyrime konkrete që duhet të zbatohen edhe gjatë ndërveprimit me viktimat dhe dëshmitarët<sup>33</sup>.

## Neni 10

### Roli i drejtuesit të prokurorisë

1. Drejtuesi i prokurorisë është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe sigurimin e efikasitetit dhe ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorisë<sup>34</sup>. Në kuptim të këtij udhëzimi, drejtuesi i prokurorisë është përgjegjës për krijimin e kushteve që bëjnë të mundur respektimin e detyrimeve të prokurorisë ndaj viktimave të veprave penale.

2. Për realizimin e këtij roli, drejtuesi i prokurorisë:

a) përfshin në strukturën e prokurorisë sektorin ose, të paktën, koordinatorin e asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm<sup>35</sup>, duke mbajtur parasysh që përbërja e këtij sektori dhe përshkrimi i punës për secilin punonjës duhet të ndjekë udhëzimet e strukturës standarde të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm dhe ngarkesën e punës dhe nevojat specifike të asaj prokurorie<sup>36</sup>;

b) përfshin në strukturën e prokurorisë seksionin për të miturit, në rast se gjykata përkatëse e ka një të tillë<sup>37</sup>, duke mbajtur parasysh që përbërja e këtij seksioni duhet të ndjekë udhëzimet e strukturës standarde të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm dhe ngarkesën e punës dhe nevojat specifike të asaj prokurorie;

c) mbikëqyr disiplinën në punë dhe respektimin e etikës së prokurorit<sup>38</sup> dhe, në funksion të kësaj, jep mendim për vlerësimin profesional të prokurorit<sup>39</sup> dhe mund të kërkojë fillimin e inspektimit<sup>40</sup>;

ç) drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e sektorit të asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm në atë prokurori;

d) drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e policisë gjyqësore nën juridiksionin e prokurorisë<sup>41</sup>, duke përfshirë nxjerrjen e urdhrave të detyrueshëm<sup>42</sup>;

<sup>32</sup> Neni 3, "Parimet themelore".

<sup>33</sup> Shih detyrimet konkrete në rregullat e parashikuara nga neni 4, pika "dh"; neni 5, pika "b"; neni 7, pika "b"; neni 8, pika "c"; neni 9, pika "c" dhe neni 14, paragrafi 3.

<sup>34</sup> Neni 52 i ligjit nr. 97/2016.

<sup>35</sup> Nenin 68 i ligjit 97/2016 kërkon krijimin e sektorit të asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm në secilën prokurori të juridiksionit të zakonshëm, por detyrimi i drejtuesit të prokurorisë mund të realizohet vetëm brenda burimeve njerëzore e financiare të disponueshme.

<sup>36</sup> Nenet 20 dhe 42, pika "j", të ligjit nr. 97/2016.

<sup>37</sup> Neni 21, paragrafi 1, i ligjit 97/2016.

<sup>38</sup> Neni 42, pikat "dh" dhe "k", të ligjit nr. 97/2016.

<sup>39</sup> Neni 87 i ligjit nr. 96/2016.

<sup>40</sup> Neni 119 i ligjit nr. 96/2016.

<sup>41</sup> Neni 42, pika "gj", i ligjit nr. 97/2016.

<sup>42</sup> Neni 43 i ligjit nr. 97/2016.

dh) miraton rregulloren e brendshme të prokurorisë, e cila mund të rregullojë çështje specifike që lidhen me asistencën ndaj viktimave në juridiksionin përkatës<sup>43</sup>;

e) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim, të cilët janë të detyrueshëm për prokurorët<sup>44</sup>;

ë) nxjerr udhëzime jo të detyrueshëm për çështje konkrete<sup>45</sup>;

f) raporton tek Prokurori i Përgjithshëm lidhur me funksionimin e prokurorisë<sup>46</sup>;

g) siguron bashkërendimin e punës mes sektorit të asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm në atë prokurori dhe Drejtorisë që mbulon Asistencën ndaj Subjekteve me Status të Posaçëm në Prokurorinë e Përgjithshme<sup>47</sup>;

gj) i propozon Prokurorit të Përgjithshëm ndryshime në buxhet dhe personel për të garantuar asistencën ndaj viktimave sipas specifikave të prokurorisë<sup>48</sup>;

h) sigurohet që administrimi financiar dhe material në prokurori u shërben qëllimeve të garantimit të asistencës ndaj viktimave<sup>49</sup>.

2. Për çështjet e parashikuara nga pikat “a”, “b”, “dh” dhe “gj” të paragrafit të parë të këtij neni, drejtuesi i prokurorisë merr mendimin e mbledhjes së prokurorëve<sup>50</sup>.

## Neni 11

### Roli i punonjësit të policisë gjyqësore

Gjatë fazës së hetimeve paraprake, punonjësi i policisë gjyqësore respekton dhe zbaton të drejtat e viktimës, bazuar në Kodin e Procedurës Penale dhe në këtë udhëzim. Për ushtrimin e kësaj përgjegjësie, punonjësi i policisë gjyqësore vepron vetë ose nën udhëzimet e prokurorit. Në mënyrë të veçantë, punonjësi i policisë gjyqësore:

a) merr kontaktin e parë me viktimën e mundshme dhe sigurohet që asaj, veçanërisht nëse u përket kategorive vulnerabël, t'i plotësohen nevojat urgjente dhe t'i garantohet siguria fizike. Për këtë qëllim, policia gjyqësore bashkëpunon me shërbimet sociale dhe organizata jo qeveritare, sipas rastit;

b) i jep viktimës së mundshme informacionin e parë lidhur me të drejtat e saj dhe me mënyrën e funksionimit të sistemit të drejtësisë penale<sup>51</sup> dhe e vendos në kontakt me shërbimin social në nivel vendor, si edhe me ofrues joqeveritarë të shërbimeve, nëse është rasti<sup>52</sup>;

c) merr kallëzimin ose deklaratimet e viktimës, duke respektuar rregullat e parashikuara në KPP;

<sup>43</sup> Neni 42, pika “j”, i ligjit nr. 97/2016.

<sup>44</sup> Neni 46 i ligjit nr. 97/2016.

<sup>45</sup> Neni 48 i ligjit nr. 97/2016.

<sup>46</sup> Neni 50 i ligjit nr. 97/2017.

<sup>47</sup> Neni 42, pika “e”, i ligjit nr. 97/2016.

<sup>48</sup> Neni 40 i ligjit 97/2016.

<sup>49</sup> Neni 52 i ligjit 97/2016.

<sup>50</sup> Neni 55 i ligjit nr. 97/2016.

<sup>51</sup> Neni 58, paragrafi 2, i KPP-së.

<sup>52</sup> Neni 58, paragrafi 1, pika “b”, i KPP-së.

ç) i raporton prokurorit lidhur me kontaktin me viktimën, si edhe periodikisht ose me kërkesën e prokurorit për aktivitetin e tij të mëvonshëm lidhur me viktimën. Raportimi është i detyrueshëm dhe i menjëhershëm në rastet kur viktimia u përket kategorive veçanërisht vulnerabël, gjendet në situatë rreziku apo kur ka të dhëna për ekzistencën e viktimave të tjera<sup>53</sup>;

d) mbledh informacion të vlefshëm për identifikimin dhe njoftimin e viktimës<sup>54</sup>. Në rast se ka të dhëna për viktimia të tjera, merr masa për identifikimin dhe njoftimin e tyre, duke i raportuar prokurorit apo kërkuar udhëzime prej tij;

dh) trajnohet dhe merr njohuri të posaçme në fushën e drejtësisë penale për të miturit, nëse është caktuar për të hetuar çështje që i përkatësin seksionit për të miturit në prokurorinë përkatëse<sup>55</sup>.

## Neni 12

### **Struktura që mbulon asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm**

1. Struktura që mbulon asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm përbëhet nga drejtoria përgjegjëse për asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm në Prokurorinë e Përgjithshme dhe sektorët e asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm.

2. Detyrat e strukturës që mbulon asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm përcaktohen në Kreun VII të këtij udhëzimi.

3. Procedurat standarde të veprimit të strukturës që mbulon asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm përcaktohen me udhëzim të Prokurorit të Përgjithshëm.

## Neni 13

### **Raportimi për zbatimin e udhëzimit**

1. Drejtoria ngarkohet me detyrën e monitorimit të zbatimit të këtij udhëzimi nga sistemi i prokurorisë. Në zbatim të kësaj detyre, drejtoria i raporton Prokurorit të Përgjithshëm, nga i cili merr edhe udhëzimet përkatëse për vazhdimësinë dhe përmirësimin e punës në ndihmë të viktimave të krimit.

2. Prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm raportojnë pranë drejtorisë, në kohën dhe sipas indikatorëve të përcaktuar prej saj.

3. Sektorët hartojnë raporte periodike dhe tematike, që i dërgohen drejtorisë. Raportet hartohen në formën dhe intervalët kohorë të përcaktuar prej kësaj të fundit.

---

<sup>53</sup> Neni 303 i KPP-së.

<sup>54</sup> Neni 293, paragrafi 1, dhe nenet 294 e 295 të KPP-së.

<sup>55</sup> Neni 29, paragrafi 2, i KDPM-së.

## **KREU II**

### **PARIMET E OFRIMIT TË ASISTENCËS NDAJ VIKTIMAVE**

#### **Neni 14**

#### **Nxitja për ofrimin e asistencës**

Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën prezumimin e parimit të ofrimit, më shumë se sa të refuzimit të asistencës ndaj viktimave të krimit. Legjislacioni në fuqi, i cituar në këtë udhëzim, përcakton asistencën që duhet të ofrohet në mënyrë të detyrueshme dhe të drejtat që mund të garantohen në gjykatë, të cilat përbëjnë një standard minimum për detyrimet e prokurorisë ndaj viktimave të krimit. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë inkurajohen të ofrojnë asistencë të natyrave të tjera ndaj viktimave të krimit, kur është e përshtatshme dhe e mundur, në varësi të rrethanave përkatëse.

#### **Neni 15**

#### **Refuzimi i asistencës nga viktimat dhe ushtrimi i të drejtave**

1. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë janë të detyruar nga ligji dhe ky udhëzim të identifikojnë viktimat e krimit, t'i njoftojnë për të drejtat dhe t'u ofrojnë asistencën e përshkruar në këtë udhëzim. Megjithatë, viktimat nuk është e detyruar t'i ushtrojnë të drejtat e saj apo ta pranojnë këtë asistencë dhe mund të zgjedhë, në çdo fazë të procedimit penal, të refuzojë marrjen e asistencës ose ushtrimin e të drejtave. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë nuk janë të detyruar t'i ofrojnë asistencë ose të mbështesin në ushtrimin e të drejtave viktimën që kanë marrë një vendim për të refuzuar asistencën, duke qenë e ndërgjegjshme për pasojat.

2. Në rastet e refuzimit nga ana e viktimës, prokurori duhet të sigurohet që viktimat e kupton rëndësinë dhe pasojat e refuzimit dhe duhet të saktësojnë nëse refuzimi është për një lloj asistence apo një të drejtë apo për të gjitha ato. Në rastet e viktimës së mitur, refuzimi i asistencës pranohet vetëm nëse prindi ose përfaqësuesi ligjor japin garanci me shkrim për marrjen përsipër të dhënies nga ata vet të asistencës që kërkohet të refuzohet nga i mituri. Refuzimi i viktimës duhet të dokumentohet, por, njëkohësisht, duhet të vazhdojë ofrimi i llojeve të asistencës që nuk janë refuzuar dhe mbështetja për ushtrimin e të drejtave, nga të cilat nuk është hequr dorë.

#### **Neni 16**

#### **Koordinimi i asistencës**

Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të koordinojnë ndërmjet tyre gjatë ofrimit të asistencës së parashikuar nga ligji për viktimat. Natyra dhe shtrirja

e asistencës do të varet nga lloji i dëmit të pësuar nga viktimat dhe rrethana të tjera të ngjarjes. Kur viktimat ka nevojë për asistencë që ofrohet nga një pjesë tjetër e prokurorisë apo nga një agjenci tjetër shtetërore, personeli i prokurorisë duhet të koordinojë me to dhe duhet ta prezantojë viktimën tek zyrat ose agjencitë e tjera. Prezantimi duhet të përfshijë një shpjegim të rolit të secilës agjenci. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të mbështesin njëri-tjetrin, për atë që është e mundur, me qëllim ofrimin e asistencës së qëndrueshme që plotëson nevojat e viktimave.

## Neni 17

### **Mbrojtja e të dhënave personale**

1. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të mbajnë në vëmendje nevojën për privatësi të viktimave dhe dëshmitarëve. Në veçanti, ata duhet të mbajnë parasysh ndalimin e publikimit të të dhënave personale dhe fotografive të viktimave të mitura<sup>56</sup>, por duhet të shmangët edhe publikimi i të dhënave personale dhe fotografive të viktimave të tjera, duke i redaktuar ato nga aktet apo dokumentet që do të bëhen publikë. Të dhënat personale përfshijnë emrin e mbiemrin e viktimës, vendndodhjen e saj, numrin personal të identifikimit, datën e lindjes, adresën, numrin e telefonit dhe të dhëna të tjera që mund të lejojnë identifikimin e viktimës.

2. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë e kanë të ndaluar të bëjnë deklarime publike lidhur me identitetin, deklaratimet apo besueshmërinë e një personi që nuk ka dëshmuar ende<sup>57</sup>. Për më tepër, kur marrin kërkesa për informacion bazuar në legjislacionin për të drejtën e informimit të publikut<sup>58</sup>, ata duhet të mbajnë parasysh se të dhënat personale të viktimave dhe dëshmitarëve mund të jenë të mbrojtura nga KPP-ja, KDPM-ja dhe legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të mbajnë parasysh se detyrimi për ruajtjen e sekretit hetimor dhe ndalimi për publikimin e akteve vlejné edhe për ruajtjen e privatësisë së viktimës dhe mund të jenë thelbësorë për garantimin e sigurisë së saj fizike nga kërcënimet e të dyshuarit. Për çdo dyshim lidhur me statusin “*sekret*” të aktit, kur nga publikimi mund të cenohen interesat e viktimës, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të kërkojnë udhëzime nga prokurori.

4. E drejta e të pandehurit për të marrë kopje të akteve, si edhe e drejta e pjesëmarrësve të tjerë në procedim dhe e publikut për informacion nënkupton që prokurori shpesh herë ka detyrimin të japë kopje të akteve të procedimit. Për këtë arsye, aktet e procedimit duhet të hartohen duke mbajtur në mend këtë fakt. Në to nuk duhet të përfshihen të dhëna personale të viktimës që nuk janë të domosdoshme për vlefshmërinë e aktit dhe që nuk është e nevojshme të

<sup>56</sup> Neni 103 i KPP-së dhe neni 21 i KDPM-së.

<sup>57</sup> Nenet 103 dhe 279 të KPP-së, neni 21 i KDPM-së.

<sup>58</sup> Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit”.



njihen nga publiku. Në çdo rast që jepen kopje të akteve gjatë hetimeve paraprake, ato shoqërohen me deklaratën e njohjes së përgjegjësisë për mospublikimin e aktit.

5. Kur nga shkëmbimi i informacionit me agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritetin e burgjeve dhe të shërbimit të provës mund të krijohet rrezik për viktimën, prokurori merr masat e nevojshme ose bën delegimet përkatëse për mbrojtjen e jetës së saj.

6. Prokurori duhet të verifikojë pa vonesë rastet e shkeljes së ndalimeve të parashikuara nga neni 103 i KPP-së, veçanërisht kur është vënë në rrezik jeta e viktimës, dhe duhet të ndër marrë veprimet apo të bëjë propozimet përkatëse<sup>59</sup>.

7. Prokurori ushtron kujdes të veçantë për të mos përdorur në procedim të dhëna personale të viktimës që nuk janë të nevojshme për hetimin dhe/ose gjykimin e çështjes. Nëse të dhënat duhet të përdoren në procesin gjyqësor dhe publikimi i tyre mund të çënojë interesat e viktimës, prokurori kërkon zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura<sup>60</sup> ose pyetjen e viktimës me teknika të posaçme<sup>61</sup> ose dhënien e statusit të dëshmitarit me identitet të fshehur<sup>62</sup>. Në raste të caktuara, kur zbulimi i vendndodhjes së viktimës mund të vërë në rrezik jetën e saj, prokurori merr përsipër edhe njoftimin e saj për seancën paraprake apo seancën gjyqësore.

#### Neni 18

### **Procedimi në afat të arsyeshëm<sup>63</sup>**

1. Prokurori duhet të mbajë parasysh vështirësitë dhe shqetësimet që mund t'i shkaktohen viktimës nga vonesat në hetim apo ndjekje penale dhe të veprojë në mënyrë që të shmangen sa më shumë të jetë e mundur këto pasoja. Prokurori duhet t'i përcjellë edhe gjykatës informacionin lidhur me vështirësitë që i shkaktohen viktimës nga shtyrja e seancave gjyqësore.

2. Prokurori duhet të marrë në konsideratë edhe ndikimin e vonesave dhe shtyrjeve tek viktima para se të vendosë zgjatjen e afatit të hetimeve apo të kërkojë shtyrjen e seancës gjyqësore.

#### Neni 19

### **Respektimi i dinjitetit dhe drejtësia**

1. Viktima ka të drejtën për t'u trajtuar me drejtësi dhe respekt për dinjitetin e vet njerëzor<sup>64</sup>.

2. Në themel të punës së prokurorit qëndrojnë interesat e procedimit penal dhe të drejtat e të pandehurit; megjithatë, e drejta e viktimës për drejtësi nënkupton që prokurori duhet të marrë parasysh edhe mendimin e interesat e saj gjatë formulimit të vendimmarrjes së tij për çështjen.

<sup>59</sup> Neni 104 i KPP-së.

<sup>60</sup> Neni 340 i KPP-së.

<sup>61</sup> Neni 361, paragrafët 7 dhe 8, i KPP-së dhe 43 i KDPM-së.

<sup>62</sup> Neni 165/a i KPP-së.

<sup>63</sup> Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe neni 42 i Kushtetutës. Neni 17 i KDPM-së.

<sup>64</sup> Neni 9/a i KPP-së.

3. Prokurori, oficeri i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të mbrojnë dinjitetin e viktimës, veçanërisht atyre që janë më vulnerabël. Për aq sa është e mundur, prokurori duhet ta informojë viktimën për natyrën e provave që do të paraqiten e debatohen në seancë gjyqësore. Prokurori duhet t'i paraqesë provat në seancë gjyqësore në mënyrë të tillë që nuk cënon të drejtën e viktimës për t'u trajtuar me respekt. Gjithashtu, prokurori duhet të kundërshtojë sa herë që mbrojtja paraqet pretendime apo prova që shërbejnë për të cënuar dinjitetin e viktimës më shumë se sa për të mbrojtur të pandehurin. Prokurorët inkurajohen të përdorin mjetet ligjore ekzistuese sa herë besojnë se provat që do të shqyrtohen në seancë gjyqësore mund të cënojnë dinjitetin e viktimës.

### **KREU III TË DREJTAT E VIKTIMËS**

#### Neni 20

#### **Kallëzimi penal**

1. Viktima ka të drejtën dhe detyrimin për të kallëzuar veprën penale që ndiqet kryesisht<sup>65</sup>. Personit që pretendon se është viktimë e një vepre penale nuk mund t'i refuzohet marrja e kallëzimit që i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit<sup>66</sup>.

2. Prokurori dhe punonjësi i policisë gjyqësore hetojnë pa vonesë rastet kur kanë arsye të dyshojnë se ndryshimi i thënieve të viktimës që ka bërë kallëzim janë bërë për shkak të kanosjes.

#### Neni 21

#### **Ofrimi i shërbimeve**

1. Viktima ka të drejtën për të përfituar kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për asistencën ndaj viktimave të veprës penale<sup>67</sup>.

2. Prokurori dhe punonjësi i policisë gjyqësore duhet:

a) të jenë të ndërgjegjshëm për arsyen e parashikimit të kësaj të drejte dhe nevojën që kanë viktimat për këto lloj asistencash<sup>68</sup>;

b) të lejojnë që asistenca sipas paragrafit të parë të këtij neni të jepet para marrjes së deklarimeve të viktimës, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e rastit;

c) t'i japin koordinatorit të caktuar për çështjen konkrete të gjithë informacionin e nevojshëm që lejon të përcaktohen shërbimet më të përshtatshme për viktimën;

<sup>65</sup> Nenet 58, paragrafi 1, pika "a", dhe 283 të KPP-së.

<sup>66</sup> Neni 284 i KPP-së.

<sup>67</sup> Neni 58, paragrafi 1, i KPP-së.

<sup>68</sup> Shih veçanërisht nenet 33- 36 të këtij udhëzimi.

ç) të referojnë viktimën tek shërbimet e përshtatshme, nëse koordinatori mungon apo nuk është e mundur të pritët prania e koordinatorit.

d) të kenë kujdes në ndërmarrjen e veprimeve procedurale që mund të ndërhyjnë në përfitimin e shërbimeve nga ana e viktimës.

3. Koordinatori i jep viktimës informacion lidhur me shërbimet e disponueshme dhe të përshtatshme për rrethanat e saj. Nëse është i nevojshëm një mendim më i specializuar për të përcaktuar se çfarë asistence nevojitet, koordinatori kërkon vlerësimin e viktimës ose, në raste kur duhet të vlerësohet edhe dëmi për efekt të përgjegjësisë penale, i sugjeron prokurorit kryerjen e ekzaminimeve mjeko-ligjore.

4. Informacioni për shërbimet do të përfshijë emrin, titullin, adresën dhe numrin e telefonit të personit përgjegjës, të cilit duhet t'i drejtohet kërkesa, si dhe llojin e shërbimit. Në rast se për përfitimin e shërbimit apo përfitimin e tij pa pagesë nevojitet referimi apo dokumentacion nga prokuroria, koordinatori ia vë këto në dispozicion viktimës, duke zbatuar rregullat për sekretin hetimor.

5. Në çdo rast, punonjësi i policisë gjyqësore dhe/ose koordinatori bëjnë referimin e viktimës në shërbimet mjekësore apo sociale të emergjencës.

## Neni 22

### Asistenca gjuhësore

1. Në të gjithë fazat e procedimit përdoret gjuha shqipe<sup>69</sup>. Viktima që nuk di shqip përdor gjuhën e saj ose një gjuhë që e njeh dhe, me anën e përkthyesit, ka të drejtë të flasë e të marrë dijeni për provat e aktet, si dhe për zhvillimin e procedimit<sup>70</sup>. Procesverbalit mbahet në gjuhën shqipe. Personat që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin kanë të drejtë të përdorin gjuhën e shenjave<sup>71</sup>.

2. Prokurori ose punonjësi i policisë gjyqësore caktojnë përkthyesin menjëherë sapo vihen në dijeni të nevojës për të. Përkthyesi caktohet edhe kur prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore e njohin gjuhën që duhet të përkthehet<sup>72</sup>.

3. Shpenzimet e përkthimit dhe interpretimit paguhen nga shteti<sup>73</sup>.

## Neni 23

### Mbrojtja

1. Viktima ka të drejtën për të zgjedhur mbrojtësin e vet<sup>74</sup>. Prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore nuk mund të refuzojnë praninë e mbrojtësit të zgjedhur në të gjitha ato raste kur prania e viktimës është e lejuar.

<sup>69</sup> Neni 8 i KPP-së.

<sup>70</sup> Nenet 8, 58, 98 dhe 123 të KPP-së.

<sup>71</sup> Po aty.

<sup>72</sup> Neni 98 i KPP-së.

<sup>73</sup> Neni 8 i KPP-së

<sup>74</sup> Mishëron parimin se viktimat i përfaqësojnë vetë interesat e tyre.

2. Kategoritë e mëposhtme të viktimave kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike parësore e dytësore falas<sup>75</sup>:

- a) viktimat e dhunës në familje;
- b) viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore;
- c) viktimat e mitura;
- ç) fëmijët që jetojnë në institucionet e përkujdesit shoqëror;
- d) fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- dh) personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- ë) personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- g) personat që provojnë se kanë të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme, sipas kriterëve të ligjit përkatës<sup>76</sup>.

3. Prokurori, oficeri i policisë gjyqësore informojnë viktimën që i përket një ose më shumë prej kategorive të mësipërme për të drejtën për ndihmë juridike falas dhe i japin informacion për procesin e përfitimit të kësaj ndihme<sup>77</sup>.

4. Në rastin e viktimës së papërfaqësuar, prokurori duhet t'i bëjë të ditur se mes prokurorit dhe viktimës nuk ekziston marrëdhënie klient- avokat. Prokurori duhet ta bëjë të qartë këtë rol pa deklaruar apo nënkuptuar se është i paimterësuar për viktimën dhe nuk duhet të japë këshilla ligjore, përveçse asaj për të marrë avokat.

## Neni 24

### **E drejta për informim dhe njoftim**

1. Si pjesë e njoftimit dhe shpjegimit të të drejtave sipas nenit 47 të këtij udhëzimi, prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe/ose koordinatori i viktimave i japin viktimës informacion për:

- a) të drejtën për informim, sipas nenit 279/a të KPP-së dhe paragrafëve 3- 9 të këtij neni;
- b) të drejtën për t'u njoftuar, sipas paragrafit 10 të këtij neni;
- c) funksionimin e sistemit të drejtësisë penale, fazat e procesit penal që janë të rëndësishme për viktimën dhe mënyrën se si mund të merret informacion për secilën nga këto faza;

<sup>75</sup> Nenet 11 dhe 12 të Ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

<sup>76</sup> Po aty.

<sup>77</sup> Kërkesa për ndihmë juridike parësore paraqitet para zyrave, organizatave ose klinikave të ndihmës juridike, kurse kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel.

ç) pozitën e viktimës në sistemin e drejtësisë penale, duke përfshirë çfarë mund të presë viktima nga sistemi, si edhe çfarë pret sistemi nga viktima.

2. Informacioni i parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni mund të jepet nëpërmjet letrës së të drejtave të viktimës dhe broshurave të hartuara për këtë qëllim, por prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe koordinatori i viktimave sigurohen që t'i shpjegojnë viktimës shkurtime dhe në mënyrë të përshtatshme të drejtat e saj.

3. Viktima ka të drejtën për të kërkuar në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit dhe për t'u njohur me aktet e provat, pa cënuar parimin e sekretit hetimor<sup>78</sup>. Kërkesa i paraqitet prokurorit me çdo formë nga viktima, përfaqësuesi ose mbrojtësi i saj. Prokurori e orienton viktimën që e paraqet kërkesën me gojë që të plotësojë formularin e hartuar për këtë qëllim. Viktima mund të tregojë shkakun, për të cilin i nevojiten informacioni, aktet ose provat, por nuk ka detyrim të provojë ekzistencën apo ligjshmërinë e këtij shkak.

4. Prokurori do të bëjë të gjitha përpjekjet për t'ia dhënë viktimës informacionin, aktin apo provën e kërkuar sipas paragrafit 3 të këtij neni. Kërkesa mund të refuzohet kur:

a) hetimi duhet të mbetet ende i fshehtë dhe rëndësia e këtij fakti është më e madhe se sa rëndësia e shkakut për të cilin viktima kërkon informacionin, aktin apo provën;

b) ekziston një interes madhor për të ruajtur jetën, sigurinë dhe të drejtat e të pandehurit, veçanërisht të drejtën për proces të rregullt ligjor<sup>79</sup>;

c) prokurori nuk ka marrë ende deklaratimet e viktimës dhe është e nevojshme të ruhet viktima nga ndikimet në kujtesën e saj.

5. Për refuzimin e kërkesës sipas paragrafit 4 të këtij neni mjafton shënimi i prokurorit në formularin e kërkesës ose në kërkesën me shkrim dhe nuk nevojitet arsyetim i detajuar, por prokurori ose koordinatori i viktimës duhet të kujdesen që viktima të kuptojë arsyet e refuzimit. Në rast se më pas bie shkak i refuzimit të kërkesës, prokurori jep informacionin, aktin apo provën edhe pa u përsëritur kërkesa nga viktima.

6. Viktima ka të drejtën të kërkojë në çdo kohë informacion për vendosjen, vazhdimin, zëvendësimin apo heqjen e masave të sigurimit ndaj të pandehurit. Në rastet kur prokurori është në dijeni të rrezikut të menjëhershëm dhe serioz që mund t'i vijë viktimës nga lirimi i të pandehurit, i kërkon gjykatës që vendimi për zëvendësimin ose heqjen e masës së sigurimit t'i njoftohet edhe viktimës ose procedon vetë me njoftimin e saj<sup>80</sup>.

7. Kërkesa sipas paragrafit 6 të këtij neni i paraqitet prokurorit me çdo formë nga viktima, përfaqësuesi ose mbrojtësi i saj. Prokurori e orienton viktimën që e paraqet kërkesën me gojë që të plotësojë formularin e hartuar për këtë qëllim. Viktima nuk ka detyrim të tregojë shkakun e kërkesës sipas këtij paragrafi.

8. Prokurori do të bëjë të gjitha përpjekjet për t'ia dhënë viktimës informacionin e kërkuar sipas paragrafit 6 të këtij neni. Kërkesa mund të refuzohet vetëm kur informacioni i dhënë mund të rrezikojë jetën apo shëndetin e të pandehurit.

<sup>78</sup> Neni 297/a i KPP-së.

<sup>79</sup> Si rregull, këto janë situata që lidhen me të pandehur të mitur.

<sup>80</sup> Reference tek Konventa e Stambollit



9. Për refuzimin e kërkesës sipas paragrafit 8 të këtij neni mjafton shënimi i prokurorit në formularin e kërkesës ose në kërkesën me shkrim dhe nuk nevojitet arsyetim i detajuar, por prokurori ose koordinatori i viktimës duhet të kujdesen që viktima të kuptojë arsyet e refuzimit. Në rast se më pas bie shkak i refuzimit të kërkesës, prokurori jep informacionin edhe pa u përsëritur kërkesa nga viktima.

10. Prokurori njofton viktimën me akt të shkruar për:

a) vendimin për mosfillimin e procedimit, në ato raste kur kallëzimi është paraqitur nga viktima apo viktima ka qenë identifikuar dhe njoftuar për të drejtat<sup>81</sup>;

b) përfundimin e hetimeve<sup>82</sup>;

c) pezullimin e hetimeve<sup>83</sup>;

ç) pushimin e çështjes për kundërvajtje<sup>84</sup>;

d) paraqitjen e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes për krime<sup>85</sup>;

dh) arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë<sup>86</sup>;

e) zgjatjen e afatit të hetimit<sup>87</sup>.

11. Njoftimi i viktimës bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 137 të KPP-së. Në rastet kur nuk dihet adresa e banimit, vendi i punës ose vendbanimi i përkohshëm i viktimës<sup>88</sup>, prokurori procedon me njoftimin me shpallje sipas nenit 138 të KPP-së.

12. Njoftimi për përfundimin e hetimeve paraprake i dërgohet viktimës<sup>89</sup> ose trashëgimtarëve të saj, nëse identiteti dhe vendbanimi i këtyre të fundit rezultojnë nga aktet e procedimit<sup>90</sup>. Njoftimi përmban përshkrimin e përmbledhur të faktit penal, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje<sup>91</sup>.

13. Njoftimi përmban edhe informacionin për të drejtën e ankimit, në rast se ligji parashikon ankim ndaj aktit për të cilin bëhet njoftimi.

## Neni 25

### Kërkimi i provave dhe kërkesa të tjera

Viktima ka të drejtën të kërkojë marrjen e provave dhe të bëjë kërkesa të tjera<sup>92</sup>. Prokurori analizon rëndësinë e provës apo kërkesave të tjera nga ana e viktimës. Nëse lidhja e tyre me çështjen nuk është e qartë, prokurori kërkon nga viktima sqarime me shkrim. Prokurori

<sup>81</sup> Neni 291 i KPP-së.

<sup>82</sup> Neni 327 i KPP-së.

<sup>83</sup> Neni 326 i KPP-së.

<sup>84</sup> Neni 328 i KPP-së.

<sup>85</sup> Neni 329/a i KPP-së.

<sup>86</sup> Neni 406/d i KPP-së.

<sup>87</sup> Neni 324 i KPP-së.

<sup>88</sup> Vende të përcaktuara nga neni 140 i KPP-së, sipas referencës së bërë në nenet 137 dhe 138 të KPP-së.

<sup>89</sup> Viktimën e drejtpërdrejtë ose anëtarët e familjes, sipas rastit.

<sup>90</sup> Neni 327, paragrafi 2, i KPP-së.

<sup>91</sup> Neni 327, paragrafi 3, i KPP-së.

<sup>92</sup> Neni 58 dhe 318 të KPP-së.

mund të refuzojë marrjen e provave apo kryerjen e veprimeve vetëm nëse më parë viktimja ka deklaruar me shkrim mbi rëndësinë që ka për çështjen, prova apo veprimi i kërkuar prej tij.

#### Neni 26

### **E drejta për dëmshpërblim nga i pandehuri**

1. Padia civile është i vetmi mjet për të garantuar kompensimin e viktimës. Prokurorët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e saj dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të viktimës që lidhen me ngritjen e padisë civile.

2. Prokurori administron padinë civile, nëse ajo është paraqitur nga viktimja ose përfaqësuesi/mbrojtësi i saj gjatë fazës së hetimeve paraprake<sup>93</sup> dhe, për aq sa është e mundur në rrethanat e çështjes konkrete, i jep viktimës kopje të akteve të dosjes hetimore që mbështesin padinë civile në procesin penal. Në rastin e padisë civile, prokurori bashkëpunon me viktimën për të kërkuar bashkërisht vendosjen e sekuestros konservative<sup>94</sup>.

3. Në rastet e veprave penale që kanë shkaktuar dëme të natyrës pasurore, prokurori i sugjeron viktimës të plotësojë deklaratën për dëmin. Deklarata e dëmit shërben për të orientuar kërkimin e provave të nevojshme për çështjen penale apo padinë civile.

#### Neni 27

### **Përfjashtimi nga tarifat**

1. Viktimja gëzon të drejtën për t'u përfjashtuar, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarifës gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale.

2. Kategoritë e përmendura në nenin 23, paragrafi 2, të këtij udhëzimi kanë të drejtën për përfjashtim nga:

a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;

b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislativës procedurale;

c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

3. Prokurori, oficeri i policisë gjyqësore informojnë viktimën që i përket një ose më shumë prej kategorive të mësipërme për të drejtën për përfjashtim nga tarifat dhe i japin informacion për procesin e përfitimit të kësaj ndihme<sup>95</sup>.

<sup>93</sup> Neni 62, paragrafi 1, i KPP-së.

<sup>94</sup> Nenet 63 dhe 270 të KPP-së.

<sup>95</sup> Neni 58/1 paragrafi "gj". Kërkesa për ndihmë juridike parësore paraqitet para zyrave, organizatave ose klinikave të ndihmës juridike, kurse kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel.

Neni 28  
**Dëshmia e viktimës**

1. Prokurori duhet të jetë i ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka dëshmia e viktimës, jo vetëm për çështjen penale, por edhe për vetë viktimën. Dhënia e dëshmisë është mundësia e vetme e viktimës për të treguar faktet e ngjarjes, por edhe ndikimin që ka patur vepra penale në jetën e vet.

2. Prokurori merr të dhëna nga viktima në bazë të nenit 312 të KPP-së.

3. Prokurori kërkon sigurimin e dëshmisë së viktimës kur:

a) ka arsye të bazuara për të menduar se viktima nuk mund të pyetet në shqyrtimin gjyqësor për shkak sëmundjeje ose pengesë tjetër serioze;

b) ka arsye të bazuara për të menduar se viktima mund të jetë objekt dhune, kanosje ose premtimi për t'i dhënë para ose përfitime të tjera me qëllim që të mos bëjë dëshmi ose të bëjë dëshmi të gënjeshtërt<sup>96</sup>.

4. Viktima mund t'i kërkojë prokurorit të procedojë me kërkesë për sigurimin e provës<sup>97</sup>. Prokurori duhet të japë vendim të arsyetuar për refuzimin e kërkesës.

5. Prokurori mban gjithmonë parasysh ndalimin e kryerjes së ballafaqimit së të pandehurit me viktimën ose dëshmitarin e mitur<sup>98</sup>, por edhe pasojat negative që mund të sjellë për viktimën e rritur kryerja e ballafaqimit mes të pandehurit dhe viktimës, veçanërisht asaj vulnerabël. Ballafaqimi midis të pandehurit dhe viktimës së rritur, kur kryen hetime për vepra penale të kryera ndaj jetës dhe shëndetit, krime seksuale apo krime të kryera me dhunë psikike apo fizike duhet të paraprihet me informimin e viktimës. Nëse viktima refuzon, prokurori duhet të vlerësojë të mos kryejë ballafaqimin nisur nga pasojat negative që mund të rrjedhin prej tij për viktimën.

Neni 29  
**E drejta për pjesëmarrje**

1. Viktima ka të drejtën të njoftohet dhe të marrë pjesë në seancën paraprake<sup>99</sup> dhe në seancë gjyqësore<sup>100</sup>. Prokurori, si rregull, duhet të mbështesë viktimën në ushtrimin e të drejtës së saj për pjesëmarrje.

2. Nëse dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë apo deklaratimet e të pandehurit mund ta vendosin viktimën në situatë viktimizimi të përsëritur apo mund të thellojnë dëmin e shkaktuar nga vepra penale, prokurori e informon viktimën, në mënyrë që ajo të marrë një vendim të informuar lidhur me pjesëmarrjen.

---

<sup>96</sup> Neni 316 i KPP-së.

<sup>97</sup> Neni 318 i KPP-së.

<sup>98</sup> Neni 169 i KPP-së.

<sup>99</sup> Neni 332/a i KPP-së.

<sup>100</sup> Neni 333 i KPP-së.

3. Prokuroria nuk ka detyrim të organizojë apo lehtësojë pjesëmarrjen e viktimës në seancë paraprake apo në gjykim, por mund ta bëjë këtë nëse e gjykon të nevojshme dhe burimet financiare e njerëzore të institucionit e lejojnë.

#### Neni 30

### **E drejta për ankim**

1. Viktima ka të drejtë të bëjë ankim kundër:

- a) vendimit të prokurorit për mosfillimin e çështjes<sup>101</sup>;
- b) vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes për kundërvajtje penale<sup>102</sup>;
- c) vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake për pushimin e çështjes për krime<sup>103</sup>;
- ç) vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit hetimor<sup>104</sup>;
- d) vendimit të prokurorit për pezullimin e hetimeve<sup>105</sup>.

2. Viktima njoftohet për të drejtën për ankim me aktin që i njofton për vendimin, për të cilin lejohet ankimi.

#### Neni 31

### **Mbrojtja e arsyeshme fizike**

1. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë kanë detyrimin të mbrojnë jetën dhe shëndetin e viktimës, si pjesë e të drejtës së saj kushtetuese për jetë<sup>106</sup>.

2. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të përdorin diskrecionin dhe gjykimin e tyre të kujdesshëm gjatë vlerësimit të kërcënimeve ndaj viktimës dhe mundësive që ekzistojnë për mbrojtjen e saj. Ata duhet të marrin në konsideratë problemet e sigurisë së viktimës gjatë gjithë procedimit penal dhe duhet të konsultohen e të koordinojnë me Policinë e Shtetit, Shërbimin e Provës, autoritetin e burgjeve dhe agjenci të tjera që kanë polici gjyqësore, me qëllimin për të plotësuar nevojat për siguri të viktimës. Nga ana tjetër, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të referojnë tek prokurori i çështjes çdo shqetësim lidhur me sigurinë e viktimës, si dhe çdo kallëzim apo provë për kërcënime të mundshme ndaj saj. Viktima duhet të informohet për mënyrat që mund të jenë të disponueshme për të garantuar sigurinë e saj.

3. Prokurori merr vetë ose udhëzon Policinë e Shtetit për marrjen e masave të arsyeshme dhe të përshtatshme për të mbrojtur viktimën nga i pandehuri, nga persona që veprojnë në bashkëpunim me të apo në emër të tij. Arsyeshmëria dhe përshtatshmëria kanë të bëjnë me nivelin e mbrojtjes që u përshtatet rrethanave të rastit dhe nivelit të rrezikut, të cilat, sipas

---

<sup>101</sup> Neni 291 i KPP-së.

<sup>102</sup> Nenet 328 e 329 i KPP-së.

<sup>103</sup> Neni 329/b i KPP-së.

<sup>104</sup> Neni 325 i KPP-së.

<sup>105</sup> Neni 326 i KPP-së.

<sup>106</sup> Neni 21 i Kushtetutës.

vlerësimit dhe analizës së kryer në bashkëpunim mes prokurorit dhe Policisë së Shtetit, i përgjigjen nevojës së ngutshme për siguri, brenda burimeve financiare dhe njerëzore të secilës agjenci. Masa të tilla mund të jenë, ndër të tjera:

a) shmangia e kontaktit të drejtpërdrejtë midis viktimës dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit<sup>107</sup>;

b) paraqitja e kërkesës për nxjerrjen e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje<sup>108</sup>, urdhri mbrojtjeje<sup>109</sup> ose urdhri kufizimi në gjykatë<sup>110</sup>;

c) paraqitja e kërkesës për vendosjen ndaj të akuzuarit të një mase sigurimi izoluese apo të një mase sigurimi me kushtin e ndalimit të kontaktit me viktimën;

ç) paraqitja e kërkesës për dhënien e statusit të dëshmitarit me identitet të fshehur<sup>111</sup>;

d) rekomandimi për pranimin e viktimës që është edhe dëshmitar në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve;

dh) marrja e masave për mbrojtjen fizike të viktimës.

4. Përgjegjësia për të siguruar mbrojtje fizike të arsyeshme dhe të përshtatshme për viktimën, sipas vlerësimit të bërë në bashkëpunim me prokurorin, i ngelet Policisë së Shtetit gjatë gjithë procesit penal.

## Neni 32

### **Kthimi i pasurisë**

1. Prokurori disponon me urdhërimet e nevojshme që prona e viktimës, që mund të jetë sekuestruar për qëllime prove, të mbahet në gjendje të mirë dhe t'i kthehet viktimës menjëherë sapo pushon nevoja e provueshmërisë. Prokurori duhet të marrë masa për ta njoftuar viktimën në rast se pritet që prona të shkatërrohet apo të dëmtohet në mënyrë thelbësore, si pasojë e mbajtjes për qëllime të procedimit penal.

2. Paragrafi i parë i këtij neni nuk krijon detyrime ndaj viktimës në rast të sekuestrimit prej saj të sendeve të paligjshme.

## Neni 33

### **Njoftimi i punëdhënësit dhe debitorëve**

Me kërkesë të viktimës, personeli duhet ta ndihmojë atë në lidhje me:

a) njoftimin e punëdhënësit ose institucionit arsimor ku ai studion për mungesa eventuale për shkak të pjesëmarrjes në procedim;

<sup>107</sup> Neni 37 i KDPM-së, por i njëjti arsyetim mund të përdoret edhe për viktima të rritura. Mënyrat se si mund të shmangët kontakti mes viktimës dhe të akuzuarit përfshijnë thirrjen e tyre për t'u pyetur në kohë të ndryshme, marrjen e masave për shoqërimin e viktimës në seancë gjyqësore dhe mbajtjen e saj në ambiente të ndryshme nga akuzuari, kërkesa për pyetjen e viktimës nga trupi gjykues apo me video-konferencë, në rastet e lejuara nga ligji.

<sup>108</sup> Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

<sup>109</sup> Po aty.

<sup>110</sup> Neni 37 i KDPM-së.

<sup>111</sup> Neni 165/a i KPP-së.



b) njoftimin e kreditorëve, në rast se vepra penale apo pjesëmarrja në procedim mund të shkaktojnë vonesa në pagesat e detyrimeve.

Neni 34

### Ndihma me natyrë logjistike

Personeli i prokurorisë njofton paraprakisht viktimën lidhur me shërbimet e transportit, akomodimit, nëse ai banon në një rreth tjetër gjyqësor, praninë e psikologut, përkthimin dhe shërbime të tjera që lidhen me pjesëmarrjen në procedim.

## KREU IV

### FITIMI I STATUSIT TË VIKTIMËS

Neni 35

### Kuptimi i “viktimës së veprës penale”

1. Për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, me “viktimë” kuptohet *individ i që ka pësuar dëm, përfshirë dëm fizik, emocional ose humbje ekonomike, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve, kryerja e të cilave përbën veprë penale, pavarësisht nëse autori i veprës penale identifikohet, arrestohet, ndiqet penalisht apo dënohet dhe pavarësisht nga lidhjet e gjakut apo të krushqisë mes tij dhe autorit të veprës.*

2. Në rastin e individit të vrarë si pasojë e një veprë penale, për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, me “viktimë” kuptohet anëtari i familjes së tij, i cili ka pësuar dëm për shkak të vdekjes. “Anëtar i familjes” është:

- a) prindi dhe fëmija;
- b) bashkëshorti ose ai që bashkëjetonte me të në kohën e vdekjes;
- c) motra dhe vëllai;
- ç) personi në ngarkim të tij, nga pikëpamja financiare.

3. “Trashëgimtar i viktimës” është trashëgimtari ligjor ose testamentar me titull universal, në kuptim të Kodit Civil<sup>112</sup>, përveç personave të listuar në paragrafin 2 të këtij neni, sepse këta të fundit paraqiten drejtpërdrejt si viktima. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor<sup>113</sup>.

4. Trashëgimtari i viktimës gëzon vetëm këto të drejta<sup>114</sup>:

- a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;
- b) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;

<sup>112</sup> Nenet 360 e vijues dhe 377 të Kodit Civil.

<sup>113</sup> Neni 58, paragrafi 4, i KPP-së.

<sup>114</sup> Po aty.

c) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjyqimit;

ç) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;

d) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal<sup>115</sup>.

#### Neni 36

### Përfaqësimi i viktimës

1. Nëse viktima është nën 18 vjeç ose ka një paaftësi fizike apo intelektuale, asistenca i jepet nëpërmjet (sipas radhës) kujdestarit të posaçëm të caktuar nga gjykata<sup>116</sup>, kujdestarit ligjor, përfaqësuesit ligjor, bashkëshortit, prindit, fëmijës ose motrës/vëllait. Në çdo rast që vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit ligjor, prokurori mund t'i drejtohet gjykatës për caktimin e një kujdestari të posaçëm<sup>117</sup>.

2. Viktima mund të ketë më shumë se një përfaqësues nga ata të përmendur më lart, në varësi të rrethanave. Personi i akuzuar apo i dyshuar për veprën penale nuk mund të jetë përfaqësues i viktimës, edhe nëse është përfaqësues apo kujdestar ligjor i saj. Në këto raste, zbatohet neni 58/3 i KPP-së dhe paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni.

3. Prokurori cakton një përfaqësues procedural për viktimën e mitur, në rast se ndodhet përpara njëres prej situatave të mëposhtme të ngutshme dhe nuk është e mundur apo e dëshirueshme të procedohet me caktimin e kujdestarit të posaçëm<sup>118</sup>:

a) është e pamundur që brenda një ore nga sjellja e të miturit në mjediset e organit procedues të gjendet përfaqësuesi ligjor;

b) i mituri nuk jeton me përfaqësuesin e tij ligjor dhe/ose refuzon ta kontaktojë atë;

c) përfaqësuesi ligjor vepron në kundërshtim me interesat e të miturit;

ç) i mituri është viktimë ose dëshmitar i një vepre penale të kryer nga përfaqësuesi i tij ligjor;

d) përfaqësuesi ligjor nuk është i disponueshëm.

4. Përfaqësuesi procedural caktohet nga lista e dërguar nga Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, pasi të jetë marrë edhe mendimi i të miturit<sup>119</sup>. Caktimi i përfaqësuesit procedural nuk largon detyrimin për të proceduar me caktimin e kujdestarit të posaçëm, në rastet kur pengesa e përfaqësuesit ligjor vazhdon edhe pas kalimit të situatës së ngutshme.

#### Neni 37

### Identifikimi i viktimës

<sup>115</sup> E drejta për të ngritur padi për të kërkuar shpërblimin e dëmit, sipas nenit 61 të KPP-së dhe 640 e vijues të Kodit Civil nuk kufizohet tek trashëgimtarët ligjorë apo testamentarë të një personi.

<sup>116</sup> Neni 58, paragrafi 3, i KPP-së.

<sup>117</sup> Po aty dhe nenet 264, 275, 281 e 308 të Kodit të Familjes.

<sup>118</sup> Neni 74 i KDPM-së.

<sup>119</sup> Po aty.

1. Identifikimi i viktimës nënkupton identifikimin e emrit dhe adresës së viktimës. Përgjegjësia për identifikimin e viktimës i ngelet prokurorit gjatë gjithë procedimit penal.

2. Në aktin e referimit të veprës penale, punonjësi i policisë gjyqësore bën identifikimin e viktimave të mundshme, për aq sa është e mundur në rrethanat e çështjes konkrete. Në çdo rast, ai shënon në akt çdo informacion që mund të shërbejë për identifikimin e viktimave të mundshme.

3. Prokurori ka detyrim të identifikojë viktimën menjëherë pas konstatimit të ekzistencës së një vepre penale. Dhënia e statusit të viktimës në procedimin penal bëhet nëpërmjet dhënies së letrës së të drejtave të viktimës. Njoftimi i viktimës që nuk është edhe kallëzues bëhet kur është e mundur që asistencë ndaj saj të jepet pa dëmtuar hetimin. Zakonisht, ky është momenti i regjistrimit të procedimit.

4. Gjatë procedurës së verifikimit, para se të jetë vendosur mosfillimi apo regjistrimi i procedimit, si rregull, prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë nuk kanë detyrime ndaj viktimës.

5. Identifikimi dhe gjetja e viktimës mund të jetë e vështirë në çështjet me shumë viktima. Si metodat klasike hetimore, ashtu edhe teknologjitë e reja mund të përdoren për identifikimin e viktimave<sup>120</sup>. P.sh.: njoftime në gazeta apo në faqe interneti për t'u kërkuar viktimave që të kontaktojnë me prokurorinë ose policinë; numra me ose pa pagesë, në të cilët viktimat mund të identifikohen dhe të marrin informacion për asistencën e disponueshme; kontakte me spitale, shkolla, organizata joqeveritare, për të siguruar informacionin identifikues dhe kontakte; etj. Informacioni identifikues dhe kontaktet e viktimës mund të gjenden edhe në prova që i janë sekuestruar të pandehurit.

6. Në rast se ekzistojnë disa nga personat e përmendur në paragrafin 2 të nenit 35 të këtij udhëzimi, të gjithë atyre u takojnë të drejtat e parashikuara nga KPP-ja për viktimat. Pavarësisht kësaj, përparësi në njoftim dhe informim, sipas dispozitave të këtij udhëzimi do të kenë bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët. Ndaj këtyre personave ekziston edhe detyrimi i prokurorit dhe punonjësit të policisë gjyqësore për t'i identifikuar dhe njoftuar për procedimin e filluar, në të cilin ata mund të paraqiten me cilësinë e viktimës.

7. Prokurori dhe punonjësi i policisë gjyqësore nuk kanë detyrim të identifikojnë dhe njoftojnë trashëgimtarët që nuk janë njëkohësisht anëtarë të familjes, në kuptim të këtij udhëzimi. Në rast se këta trashëgimtarë paraqiten apo në rast se ekzistenca e tyre del nga aktet e procedimit, prokurori dhe punonjësi i policisë gjyqësore duhet t'u garantojë atyre ushtrimin e të drejtave që u takojnë sipas ligjit.

8. Detyrimet ndaj viktimave ushtrohen deri në momentin e përfundimit të hetimit. Që nga ky moment, asistencë ndaj viktimave mund të ofrohet në masën e lejuar nga ligji dhe nga burimet njerëzore e financiare të prokurorisë.

---

<sup>120</sup> Nenet 137 dhe 138 të KPP-së.

## Neni 38

### Dëmi

1. Përcaktimi i faktit nëse personi ka pësuar dëm kërkon një analizë të natyrës së dëmit të pësuar nga personi dhe veprës penale që mendohet se ka shkaktuar dëmin. Për t'u kualifikuar si viktimë duhet të përcaktohet se dëmi i pretenduar është pasojë direkte e veprës penale, për të cilën kryhet hetimi. Veprimet ndërhyrëse ose kontribuese të personit që ka pësuar dëmin ose të një personi të tretë mund të bëjnë që të përcaktohet se dëmi nuk është pasojë direkte e veprës që po hetohet.

2. Dëmi mund të jetë fizik, emocional ose pasuror (humbje ekonomike). Në rastet e krimeve të dhunshme, kur nuk pretendohet dëm fizik ose pasuror dhe kur viktima ka qenë e pranishme gjatë kryerjes së aktit të dhunshëm ose, edhe nëse nuk ka qenë e pranishme, ka mësuar për akte të dhunshme të kryer ose tentuar kundër saj, prezumohet se ajo (viktima) ka pësuar dëm emocional. Në të gjitha rastet e tjera, dëmi emocional nuk duhet të prezumohet në mungesë të dëmit fizik ose pasuror, por ekzistenca e tij duhet të përcaktohet në mënyrë faktike dhe objektive.

3. Personi, ndaj të cilit nuk janë kryer hetime për veprën penale specifike, por i cili ka marrë pjesë me dëshirë në aktivitetin kriminal, nuk mund të kërkojë t'i njihet statusi i viktimës<sup>121</sup>.

## Neni 39

### Persona të tjerë që janë ndikuar nga vepra penale

Në raste të caktuara, mund të ekzistojnë persona që nuk bien nën përkufizimin e viktimës, por që ndikohen nga një procedim penal i caktuar<sup>122</sup>. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë mund t'u japin atyre informacionin e kërkuar, në përputhje me ligjin dhe interesat e hetimit.

## Neni 40

### Faji

1. Personi që është fajtor ose që akuzohet për veprën penale, si pasojë e të cilit është shkaktuar dëmi, nuk konsiderohet viktimë për qëllime të garantimit të të drejtave dhe ofrimit të ndihmës së parashikuar në këtë udhëzim. Përcaktimi i faktit nëse personi është fajtor bazohet në faktet dhe rrethanat e njohura në kohën e hetimit, gjykimit ose pas dënimit dhe duhet të rivlerësohet me daljen e fakteve dhe rrethanave të reja. Personi që është fajtor për krime të tjera mund të konsiderohet viktimë për qëllimet e këtij udhëzimi.

<sup>121</sup> P.sh.: pjesëmarrësit në skemat mashtruese.

<sup>122</sup> Persona të tillë mund të jenë, p.sh.: viktima e mëparshme e dhunës në familje, e cila ndihet e kërcënuar nga fakti që autori është kapur me armë pa leje.

2. Personat që ndodhen në paraburgim ose që vuajnë dënimin penal mund të konsiderohen viktimat nëse bëhen objekt i veprës penale gjatë kohës në paraburgim/burgim. Kufizimi i lirisë së tyre mund të mos lejojë ushtrimin e të drejtave të caktuara apo dhënien e shërbimeve të caktuara.

3. Viktimat e trafikimit konsiderohen të tilla pavarësisht përgjegjësisë së tyre penale për vepra të lidhura, si kalimi i paligjshëm i kufirit apo ushtrimi i prostitucionit.

4. Dëshmitari që kërcënohet ose sulmohet fizikisht për ta penguar të dëshmojë në gjyq konsiderohet viktimë e veprës penale, pavarësisht fajit që mund të kishte lidhur me çështjen për të cilën do të dëshmonte.

#### Neni 41

### **Personat juridikë privatë**

1. Personat juridikë privatë janë viktimat të veprës penale, në kuptim të KPP-së<sup>123</sup>. Të drejtat që mund të ushtrohen nga personat juridikë janë ato të parashikuara nga pikat “d”, “dh”, “ë”, “f”, “g”, “h”, “i” dhe “j” të nenit 58, paragrafi 1, i KPP-së.

2. Të drejtat e personit juridik si viktimë e krimit ushtrohen nga përfaqësuesi i autorizuar, në përputhje me Kodin Civil. Të njëjtit person i ofrohet asistenca e detyrueshme me ligj.

#### Neni 42

### **Organet dhe agjencitë shtetërore**

1. Organet shtetërore, qendrorë apo lokalë, institucionet dhe entet publike, qeveritë e huaja dhe agjencitë e tyre nuk përfshihen në përkufizimin e viktimës së veprës penale, për qëllime të përfitimit të asistencës dhe ushtrimit të të drejtave. Të njëjtin status kanë edhe entet e pavarura apo autonome që financohen nga shteti<sup>124</sup>, si edhe shoqëritë tregëtare, të cilat kontrollohen nga shteti si aksioner kryesor dhe ofrojnë një shërbim publik ekskluziv<sup>125</sup>.

2. Organet dhe agjencitë e mësipërme mund të paraqiten si paditës civilë, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, si edhe mund të ushtrojnë të drejtat që u njihen si kallëzues, nëse kanë bërë kallëzim për veprën penale.

#### Neni 43

### **Viktimat që banojnë jashtë territorit dhe viktimat me shtetësi të huaj**

1. Të drejtat e viktimave zbatohen për shtetasin e huaj dhe personin pa shtetësi që bie nën përkufizimin e viktimës, pavarësisht nëse jeton në territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë tij.

<sup>123</sup> Nenet 58 e 61 të KPP-së.

<sup>124</sup> Psh: universitetet

<sup>125</sup> Psh: OSHEE, OST, Ujësjellës- Kanalizime



2. Njoftimi i viktimës së huaj, pa shtetësi dhe viktimës që jeton jashtë territorit të vendit bëhet në përputhje me KPP-në, përveçse kur është e nevojshme që njoftimi të bëhet sipas procedurave të ndihmës së ndërsjelltë juridike.

3. Nëse viktimja e huaj ose pa shtetësi ka nevojë për asistencë gjuhësore, ajo jepet në përputhje me KPP-në dhe këtë udhëzim. Në këto raste, duhet të mbahet parasysh koha e nevojshme për përkthim.

4. Në rastin e një të mituri të huaj që është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, rrëmbimit<sup>126</sup> ose marrjes së padrejtë<sup>127</sup>, prokurori njofton ministrinë përgjegjëse për politikën e jashtme, e cila njofton përfaqësinë diplomatike ose institucionin konsullor të shtetit përkatës<sup>128</sup>.

5. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë nuk duhet t'i japin viktimës së huaj apo pa shtetësi këshilla ligjore lidhur me të drejtën e qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, por, nëse nuk çenohet sekreti hetimor, mund t'i vënë në dispozicion akte e dokumente që janë të nevojshëm për të kërkuar lejen e qëndrimit. Në rastet kur gjykohet se marrja e lejes së qëndrimit është në interesin e viktimës, prokurori mund të kërkojë informacion për procedurën përkatëse apo të kërkojë të ndërhyjë në të, në përputhje me ligjin për të huajt<sup>129</sup>.

#### Neni 44

#### **Procedimet e një juridiksioni tjetër**

Juridiksioni penal i Republikës së Shqipërisë mund të veprojë edhe ndaj veprave penale të kryera jashtë territorit të saj ose ndaj personave të ndodhur jashtë këtij territori. Kur për të njëjtin fakt dhe të njëjtin person hetohet në Shqipëri dhe në një vend tjetër, prokurori mund të ndihmojë viktimat që ndodhen në Shqipëri me informacion lidhur me hetimin e vendit tjetër dhe pjesëmarrjen në të.

#### Neni 45

#### **Viktimat e të pandehurve të mitur**

Viktimat e veprave penale të kryera nga të miturit kanë të gjitha të drejtat dhe përfitojnë të gjithë asistencën e detyrueshëm për viktimat. Megjithatë, e drejta e tyre për informacion mund të jetë më e kufizuar, me qëllim ruajtjen e interesit më të lartë të të pandehurit të mitur<sup>130</sup>.

<sup>126</sup> Nenet 109 dhe 109/a të Kodit Penal.

<sup>127</sup> Neni 127 i Kodit Penal.

<sup>128</sup> Neni 51 i KDPM-së.

<sup>129</sup> Ligji nr. 108/2013, "Për të huajt".

<sup>130</sup> Neni 103, paragrafi 4, i KPP-së dhe nenet 21 e 43 të KDPM-së.

Neni 46  
**Viktimat e shumta**

1. Procedimet, në të cilat kanë statusin e viktimës një numër i madh personash, paraqesin vështirësi në garantimin e të drejtave. Kontakti personal me viktimën është i preferueshëm, por kjo mund të mos jetë gjithmonë e mundur në procedimet me shumë viktima.

2. Në procedimet me shumë viktima, prokurori procedon për njoftimin e tyre sipas nenit 138 të KPP-së.

3. Personeli i prokurorisë inkurajohet të përdorë teknologjitë e reja dhe mjetet e komunikimit masiv për të realizuar detyrimin për informim në rastet e procedimeve me viktima të shumta<sup>131</sup>.

Neni 47  
**Letra e të drejtave të viktimës**

1. Menjherë pas identifikimit të viktimës, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore që merr kontaktin e parë me të i jep letrën e të drejtave.

2. Letra e të drejtave përmban njoftimin për të drejtat e parashikuara në pikat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i” të paragrafit të parë të nenit 58 të KPP-së.

3. Gjatë dhënies së letrës së të drejtave, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore ia shpjegon viktimës përmbajtjen e secilës të drejtë. Koordinator i viktimave mund të jetë i pranishëm gjatë këtij momenti për të dhënë më shuma sqarime për viktimën. Këto veprime fiksohen në procesverbal, i cili nënshkruhet nga viktimat<sup>132</sup>.

**KREU V**  
**VIKTIMAT VEÇANËRISHT VULNERABËL**

Neni 48  
**Viktimat veçanërisht vulnerabël**

1. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë konsiderojnë veçanërisht vulnerabël dhe tregojnë kujdes të posaçëm për viktimën që i përket një apo me shumë prej kategorive të mëposhtme:

- a) fëmijët;
- b) viktimat e dhunës në familje, abuzimit seksual dhe përndjekjes;
- c) viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore;
- ç) viktimat me paaftësi fizike dhe intelektuale.

---

<sup>131</sup> P.sh.: email, postime në internet, etj.

<sup>132</sup> Neni 58, paragrafi 2, i KPP-së.

2. Për të rritur kapacitetet e tyre dhe zbatuar detyrat e posaçme kundrejt këtyre viktimave, prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet:

a) të njohin dhe zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga ligje të tjerë, përfshirë Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, pavarësisht nëse janë të ngarkuar me çështjet e të miturve;

b) të jenë të ndërgjegjshëm për traumën që kalon viktimat e mitur kur i kërkohet të rijetojnë krimin gjatë hetimit dhe ndjekjes penale, veçanërisht gjatë dëshmisë në gjyq, si edhe për ndikimin e përjetimit të ngjarjeve traumatike, si humbja e një njeriu të afërt apo sulmet e dhunshme<sup>133</sup>. Qëllimi kryesor i tyre duhet të jetë pakësimi i traumës që viktimat veçanërisht vulnerabël mund të përjetojnë si rezultat i kontaktit me drejtësinë penale;

c) të njohin programet e asistencës, shtetërore ose jo qeveritare, si dhe shërbimet komunitare që janë të disponueshëm në rrethin gjyqësor përkatës ose në rrethet më të afërta. Në mënyrë të veçantë, koordinatorët e viktimave duhet të jenë të familjarizuar me kërkesat për pranim në këto programe dhe të krijojnë kontakte të drejtpërdrejta me organizatat përkatëse.

3. Parimet e asistencës ndaj viktimës veçanërisht vulnerabël janë:

a) viktimat veçanërisht vulnerabël duhet të mbështetet dhe asistohet në forma dhe mënyra që janë të përshtatshme për moshën dhe gjendjen e saj specifike dhe, në rastin e viktimës së mitur, edhe prindërit e kujdestarët e tyre duhet të referohen në shërbime me natyrë komunitare;

b) vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet plotësimit të nevojave të para jetike<sup>134</sup> të viktimës veçanërisht vulnerabël, në bashkëpunim me shërbimet sociale dhe me organizata jo qeveritare, sipas rastit. Prokurori dhe punonjësi i policisë gjyqësore nuk duhet të procedojnë me marrjen e deklarimeve ose kallëzimit të viktimës veçanërisht vulnerabël pa plotësuar nevojat e saj jetike<sup>135</sup>;

c) në çdo rast që pretendohet dhunë fizike, seksuale ose abuzim me fëmijët duhet të kryhet ekzaminimi mjeko- ligjor dhe, nëse është e nevojshme, të referohet viktimat për shërbim shëndetësor pa pagesë. Viktimës nuk do t'i kërkohet në asnjë rast të paguajë për ekzaminimin mjeko-ligjor<sup>136</sup>. Megjithatë, duhet të parandalohen përpjekjet për abuzim me këtë paragraf, me qëllim përfitim të ekzaminimit mjekësor falas. Duhet të bëhen përpjekje maksimale për të bërë ekzaminimin edhe në rastet kur ankimi është i nevojshëm për ushtrimin e ndjekjes penale, por viktimat nuk bënë ankim apo e tërheq atë<sup>137</sup>;

ç) në çdo rast që vihet re papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, rrethanat i referohen prokurorit, i cili mund të caktojë një përfaqësues procedural<sup>138</sup> apo t'i kërkojë gjykatës caktimin e një kujdestari të posaçëm<sup>139</sup>;

<sup>133</sup> Dëmi emocional mund të sjellë një sërë reagimesh fiziologjike dhe psikologjike, nga dëmtimi i përkohshëm i aftësisë për të funksionuar normalisht deri tek reagime akute ndaj stresit dhe PTSD (çrregullimi i stresit post-traumatik).

<sup>134</sup> Ushqim, veshmbathje, strehim, kujdes mjekësor, etj.

<sup>135</sup> Prokuroria dhe policia gjyqësore marrin masa dhe planifikojnë për plotësimin e nevojave jetike të viktimave, qoftë edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shërbimet sociale dhe organizata jo qeveritare.

<sup>136</sup> Duke urdhëruar ekspertimin mjeko- ligjor, në bazë të neneve 179 dhe 294, paragrafi 3, të KPP-së.

<sup>137</sup> Kjo bëhet në mënyrë që provat të mblidhen dhe të jenë të disponueshme në rast se viktimat bënë ankim në një moment të mëvonshëm apo në rast se çështja ndiqet më vonë pa ankim apo nëse provat duhen më vonë për ndonjë qëllim tjetër.

<sup>138</sup> Neni 74 i KDPM-së.

d) në përputhje me rrethanat e rastit dhe nevojën për të mbrojtur viktimën, prokurori i kërkon gjykatës zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura<sup>140</sup>, pyetjen me video-konferencë<sup>141</sup>, pyetjen jashtë seancës<sup>142</sup>, sigurimin e provës<sup>143</sup> apo marrjen e statusit të dëshmitarit me identitet të fshehur<sup>144</sup>;

dh) viktimat mund të kenë nevojë për identifikimin e rreziqeve të mundshme, mundësive që ekzistojnë për t'u mbrojtur prej këtyre rreziqeve, si dhe informacion për llojin e shërbimeve dhe mbështetjes që ekziston dhe që i takon me ligj. Prokurorët duhet t'ia japin viktimës dhe grupit teknik ndërsektorial<sup>145</sup> këtë informacion, pa çënuar interesat e hetimit;

e) kur rrethanat që shoqërojnë procedimin me viktimë veçanërisht vulnerabël janë të tilla që mund të shkaktojnë situata të rënda lokale, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin e gjykimit dhe që nuk mund të mënjahohen në mënyra të tjera, prokurori inkurajohet t'i kërkojë gjykatës transferimin e çështjes<sup>146</sup>.

#### Neni 49

### Viktimat e mitura

1. Përveç parashikimeve të nenit 48 të këtij udhëzimi, prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të mbajnë parasysh sa më poshtë gjatë ndërveprimit me viktimën e mitur:

a) nëse ekziston mundësia që viktimë është e mitur dhe mosha e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur<sup>147</sup>;

b) në bazë të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur dhe legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve, Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës<sup>148</sup> luan një rol thelbësor në çdo rast kur fëmija bëhet viktimë e veprës penale;

c) prania e psikologut është e detyrueshme sa herë që pyetet viktimë e mitur<sup>149</sup>. Psikologu luan rolin e mbështetësit emocional të fëmijës dhe jo të ekspertit. Kur është e mundur, këshillohet që pyetja e viktimës së mitur të bëhet nga persona të trajnuar për këtë qëllim dhe regjistrohet, për t'u përdorur në seancë gjyqësore<sup>150</sup>;

<sup>139</sup> Neni 58, paragrafi 3, i KPP-së dhe nenet 264, 275, 281 e 308 të Kodit të Familjes.

<sup>140</sup> Neni 340 i KPP-së.

<sup>141</sup> Neni 361, paragrafët 7 dhe 8, i KPP-së.

<sup>142</sup> Nenet 58/a dhe 361/a të KPP-së.

<sup>143</sup> Nenet 316 e vijues të KPP-së.

<sup>144</sup> Neni 165/a i KPP-së.

<sup>145</sup> Neni 52 i Ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

<sup>146</sup> Neni 94 i KPP-së.

<sup>147</sup> Neni 58/a i KPP-së.

<sup>148</sup> Neni 49 i Ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

<sup>149</sup> Neni 18 i KDPM-së.

<sup>150</sup> Nenet 58/a dhe 361/a të KPP-së. Pyetja e fëmijës dhe ekzaminimi mjeko-ligjor i tij mund të jenë të vetmet prova që mbështesin akuzën, veçanërisht në rastet e abuzimit me fëmijë. Ekzaminimi mjeko-ligjor dokumenton ngjarjen dhe dëmin fizik, kurse pyetja mblledh informacion faktik nga fëmija, për të vërtetuar nëse fëmija ka qenë viktimë e një veprë penale. Pyetja duhet të jetë e përshtatshme për moshën e fëmijës dhe zhvillimin e tij, por nuk duhet të ngatërrohet me pyetjen terapeutike që bëhet me qëllimin për të përcaktuar trajtimin që i nevojitet fëmijës.

ç) përveç pranisë së përfaqësuesit, në përputhje me nënin 36 të këtij udhëzimi, viktimat e mitur ka të drejtën të shoqërohet edhe nga një person i besuar, i zgjedhur prej saj;

d) çdo rast i dyshuar i abuzimit me fëmijë, për të cilin merret dijeni gjatë ushtrimit të detyrës, duhet të hetohet ose referohet menjëherë, edhe nëse bëhet fjalë për një dyshim kundrejt viktimës. Nëse hetimi është për abuzim me fëmijët dhe personeli i prokurorisë vjen në dijeni të provave të reja, atëherë ka detyrimin t'i referojë këto prova. Referimi mund të bëhet në çdo formë, por preferohet me shkrim. Kur informacioni që tregon dyshimin për abuzim me fëmijët i takon një hetimi apo burimi sekret, duhet të bëhet çdo përpjekje për ta referuar fëmijën tek agjencitë përkatëse të mbrojtjes shoqërore, në mënyrë që t'i jepet mbrojtje. Punonjësi i policisë gjyqësore ose personeli i prokurorisë që bën referim sipas këtij paragrafi nuk mund të jetë subjekt i masave disiplinore ose hetimit për këtë referim, përveçse nëse provohet se ka vepruar në keqbesim;

dh) ruajtja e privatësisë së viktimës së mitur duhet të jetë çështje prioritare për prokurorin, punonjësin e policisë gjyqësore dhe personelin e prokurorisë. Për këtë qëllim, mbahen parasysh parashikimet e nenit 103, paragrafi 4, të KPP-së, neneve 21 dhe 43 të KDPM-së dhe neni 16 i këtij udhëzimi. Mosrespektimi i këtij parimi mund të sjellë përgjegjësi penale sipas nenit 21, paragrafi 7, të KDPM-së;

e) prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë inkurajohen të marrin pjesë në grupet teknike ndërsektoriale që krijohen në zbatim të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";

ë) duke u nisur nga natyra e veprës për të cilën është bërë referim, prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore që përgjigjen në vendngjarje duhet të marrin informacion nëse ka fëmijë. Nëse po, ata duhet të marrin masa për sigurinë dhe mirëqënien e fëmijëve<sup>151</sup>, përfshirë lajmërimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve apo specialistë të caktuar, në varësi të rrethanave të ngjarjes apo gjendjes së fëmijës. Është e këshillueshme që shërbimet e mbrojtjes së fëmijës të konsultohen përpara ndërhyrjes së agjencive të zbatimit të ligjit apo përpara se të ndërmerren veprime me fëmijën, përveçse nëse ndërhyrja është urgjente;

f) fëmija prezumohet i aftë për t'u përgjigjur. Megjithatë, prokurori duhet të kundërshtojë në çdo rast pyetjen e fëmijës drejtpërdrejt nga i pandehuri dhe të kërkojë pyetjen nga gjykata;

g) edhe pas dërgimit të çështjes në gjyq, prokurori duhet të marrë informacion nga Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe grupi teknik ndërsektorial lidhur me ndikimin e krimit tek fëmija dhe këtë informacion duhet ta përdorë për t'i rekomanduar gjykatës një masë dënimi të përshtatshme.

---

<sup>151</sup> Për të vlerësuar mirëqënien dhe sigurinë e fëmijës, merren në konsideratë edhe faktorë që kanë të bëjnë me ambientin ku ai jeton: nëse në këtë ambient përdoren ose janë përdorur armë dhe drogë, nëse ai është ekspozuar ndaj dhunës në familje, etj.



## Neni 50

### **Viktimat e dhunës në familje, abuzimit seksual dhe trafikimit**

1. Përveç parashikimeve të nenit 48 të këtij udhëzimi, prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të mbajnë parasysh se të drejtat dhe politikat për viktimat janë me rëndësi të veçantë për viktimat e dhunës në familje, abuzimit seksual dhe trafikimit. Këto krime shkaktojnë edhe traumë emocionale, përveç dëmtimeve fizike. Kallëzimi i këtyre krimeve mund të jetë më i vështirë për shkak të stigmës shoqërore dhe shpesh për shkak të marrëdhënies së vazhdueshme mes autorit dhe viktimës. Gjithashtu, këto viktima janë në rrezik të shtuar pasi kanë bërë kallëzim, gjatë hetimit dhe pasi të pandehurit të jenë liruar nga paraburgimi ose burgimi. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të njohin brishtësinë e veçantë të këtyre viktimave dhe ta kenë prioritet sigurinë e tyre.

2. Provat për të kaluarën seksuale të viktimës ose për preferencat e saj seksuale janë zakonisht të papranueshme në gjykatë<sup>152</sup>. Prokurori duhet ta ngrejë gjithmonë këtë pretendim.

3. Në ato raste kur janë të disponueshme, prokurori i kërkon gjykatës të urdhërojë të pandehurin të ndjekë programe që u drejtohen dhunuesve, si pjesë e detyrimeve që rrjedhin nga urdhri i mbrojtjes, masa e sigurimit apo vendimi përfundimtar i fajësisë.

## Neni 51

### **Viktimat me paaftësi fizike e intelektuale**

1. Prokurori, oficeri i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë duhet të jenë të ndërgjegjshëm për vështirësitë e veçanta, me të cilat mund të përballen gjatë punës me viktima që kanë paaftësi fizike apo intelektuale<sup>153</sup>. Prokurori duhet të mbajë parasysh mundësinë e sigurimit të dëshmisë së viktimës me paaftësi fizike apo intelektuale<sup>154</sup>, veçanërisht për atë që nuk lëviz nga shtëpia.

2. Kur kërkohet paraqitja e viktimës para prokurorit dhe viktima ka vështirësi fizike për t'u paraqitur, personeli duhet të përpiqet t'i organizojë transport. Të njëjtat organizime mund të bëhen paraprakisht edhe në rast të thirrjes së viktimës në gjykatë për të dëshmuar.

---

<sup>152</sup> Nenet 58/b, pika "b", dhe 153, paragrafi 2, të KPP-së.

<sup>153</sup> Këto viktima mund të ecin, dëgjojnë apo shohin me vështirësi, mund të jenë të dobët fizikisht, mund të jenë nën mjekim apo mund të kenë dhimbje kronike. Ata mund të kenë funksione konjitive të dobësuara, demencë, depresion, të cilat mund t'u shkaktojnë ankth të shtuar për pjesëmarrjen në procesin penal.

<sup>154</sup> Neni 316, pika "a", i KPP-së.

## **KREU VI PROCEDURA TË POSAÇME**

### **Neni 52**

#### **Veprat penale që ndiqen me ankimin e viktimës**

1. Për veprat penale që ndiqen me ankimin e viktimës, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e viktimës, e cila mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit<sup>155</sup>.

2. Prokurori ose punonjësi i policisë gjyqësore merr ankimin e viktimës, të paraqitur me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm. Heqja dorë nga ankimi dhe tërheqja e ankimit pranohen në të njëjtat forma. Prokurori dhe punonjësi i policisë gjyqësore hetojnë pa vonesë rastet kur kanë arsye të dyshojnë se heqja dorë nga ankimi apo tërheqja e ankimit janë bërë për shkak të kanosjes.

3. Në rastin e viktimës veçanërisht vulnerabël, zbatohen parashikimet e nenit 48, paragrafi 3, pika "c", të këtij udhëzimi.

### **Neni 53**

#### **Viktima akuzuese**

1. Për veprat penale të parashkuara në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, viktima ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve, por nuk është palë në gjykim<sup>156</sup>. Në këto raste, prokurori jep gjykimin e tij të pavarur mbi rastin, sa herë i kërkohet nga gjykata.

2. Në rast se kallëzimi paraqitet në prokurori, prokurori mbledh sa më shumë prova të jetë e mundur në ndihmë të viktimës përpara se të vendosë mosfillimin.

3. Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë nuk kanë detyrim të ofrojnë asistencë për viktimat akuzuese, përveç dhënies së kopjeve të akteve në rastin kur është bërë kallëzim më parë në prokurori.

### **Neni 54**

#### **Procedurat në rastin e urdhrit penal**

Kur është proceduar me urdhër penal<sup>157</sup>, prokurori i dërgon edhe viktimës një kopje të urdhrit penal, duke e njoftuar edhe për të drejtën për të marrë kopje të akteve që ndodhen në fashikull.

---

<sup>155</sup> Neni 284 i KPP-së.

<sup>156</sup> Neni 59 i KPP-së.

<sup>157</sup> Nenet 406/a i KPP-së.

### Procedurat në rastin e gjykimit me marrëveshje

1. Kur vendos të zhvillojë negociata për arritjen e një marrëveshjeje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit<sup>158</sup>, prokurori verifikon nëse viktimja ka plotësuar deklaratën për dëmin apo ka paraqitur padi civile në procesin penal. Nëse deklarata ose padia janë paraqitur, prokurori e bën shpërblimin e dëmit në masën e kërkuar nga viktimja një ndër kushtet e arritjes së marrëveshjes<sup>159</sup>.

2. Në çdo rast, prokurori duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar viktimën dhe për të marrë parasysh mendimin e saj lidhur me bisedimet për arritjen e marrëveshjes. Qëllimi i këtyre përpjekjeve është që t'i jepet viktimës një mundësi efektive për të dhënë mendimin e vet para se të arrihet marrëveshja formale. Për të përcaktuar nëse konsultimi me viktimën është i arsyeshëm, prokurori duhet të marrë parasysh faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në përshtatshmërinë dhe praktikitetin e këtij konsultimi. Faktorë të tillë mund të jenë:

a) rëndësia e veprës penale për sigurinë publike dhe rreziqet për sigurinë personale të viktimës;

b) numri i viktimave;

c) nëse shpejtësia është thelbësore për negociatat apo arritjen e marrëveshjes;

ç) nëse marrëveshja përmban informacion sekret apo nëse ka ndonjë arsye tjetër për të ruajtur konfidencialitetin;

d) nëse viktimja është edhe dëshmitar dhe informacioni që mund të marrë gjatë negociatave të marrëveshjes mund të ndikojë në të drejtën e të pandehurit për proces të rregullt, në rast se marrëveshja nuk miratohet.

3. Në rastin e viktimave të shumta, informimi i secilës viktimë personalisht mund të jetë i pamundur. Njoftimi i tyre mund të bëhet edhe me mjete alternative<sup>160</sup>.

4. Prokurori mund të negociojë me të pandehurin në lidhje me masën e dëmshpërbimit të viktimës, por vetëm pasi të ketë marrë pëlqimin e kësaj të fundit për masën e dëmshpërblimit. Nuk lejohet negociimi i drejtpërdrejtë mes viktimës dhe të pandehurit për masën e dëmshpërblimit që do të jetë pjesë e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Në çdo rast, viktimja duhet të japë pëlqimin me shkrim për masën e dëmshpërblimit që do të jetë pjesë e marrëveshjes<sup>161</sup>.

5. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, prokurori njofton viktimën, anëtarët e familjes ose trashëgimtarët e saj<sup>162</sup>. Njoftimi është i detyrueshëm, pavarësisht nëse dëmshpërblimi i viktimës është pjesë e marrëveshjes apo jo.

6. Në rast se dëmshpërblimi i viktimës nuk është pjesë e marrëveshjes, prokurori bashkë me kopjen e marrëveshjes, njofton viktimën për të drejtën për të marrë kopje të akteve që

<sup>158</sup> Neni 406/d, paragrafi 1, i KPP-së.

<sup>159</sup> Neni 406/d, paragrafi 3, pika "d", i KPP-së.

<sup>160</sup> Email, publikim në internet, gazetë, etj.

<sup>161</sup> Neni 406/d, paragrafi 3, pika "d", i KPP-së.

<sup>162</sup> Kur identiteti dhe vendbanimi i trashëgimtarëve rezultojnë nga aktet e procedimit.

ndodhen në fashikull.

#### Neni 56

### **Procedurat në rastin e shmangies nga ndjekja penale**

1. Kur vendos të procedojë me masën e shmangies nga ndjekja penale<sup>163</sup>, prokurori verifikon nëse viktima ka plotësuar deklaratën për dëmin apo ka paraqitur padi civile në procesin penal. Nëse deklarata ose padia janë paraqitur, prokurori e bën shpërblimin e dëmit në masën e kërkuar nga viktima një ndër kushtet e masës së shmangies, nëse kjo është e mundur në bazë të situatës dhe aftësive të të pandehurit<sup>164</sup>.

2. Në rast se prokurori rekomandon ndërmjetësimin si masë alternative, ai duhet të fiksojë në procesverbal pëlqimin e viktimës për kryerjen e ndërmjetësimit<sup>165</sup>. Nëse vlerëson se duhet të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimit, prokurori jep gjykimin e tij të pavarur mbi rastin, sa herë i kërkohet nga ndërmjetësi.

3. Në çdo rast, prokurori duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar viktimën dhe për të marrë parasysh mendimin e saj lidhur me masën e shmangies. Qëllimi i këtyre përpjekjeve është që t'i jepet viktimës një mundësi efektive për të dhënë mendimin e vet para se të arrihet marrëveshja formale. Për të përcaktuar nëse konsultimi me viktimën është i arsyeshëm, prokurori duhet të marrë parasysh faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në përshtatshmërinë dhe praktikitetin e këtij konsultimi, por, veçanërisht, interesin më të lartë të të pandehurit të mitur.

4. Në rastin e viktimave të shumta, informimi i secilës viktimë personalisht mund të jetë i pamundur. Njoftimi i tyre mund të bëhet edhe me mjete alternative<sup>166</sup>.

5. Pasi merr vendim për masën e shmangies, prokurori njofton viktimën, anëtarët e familjes ose trashëgimtarët e saj<sup>167</sup>. Njoftimi është i detyrueshëm, pavarësisht nëse dëmshpërblimi i viktimës është pjesë e kushteve të masës apo jo.

6. Në rast se dëmshpërblimi i viktimës nuk është pjesë e kushteve të masës, prokurori bashkë me njoftimin për vendimin e tij, e njofton viktimën për të drejtën për të marrë kopje të akteve që ndodhen në fashikull.

## **KREU VII**

### **STRUKTURA E ASISTENCËS NDAJ SUBJEKTEVE ME STATUS TË POSAÇËM**

#### Neni 57

### **Drejtoria që mbulon asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm në Prokurorinë e Përgjithshme**

<sup>163</sup> Neni 55 i KDPM-së.

<sup>164</sup> Nenet 61 dhe 63 të KDPM-së.

<sup>165</sup> Neni 64 i KDPM-së.

<sup>166</sup> Email, publikim në internet, gazetë, etj.

<sup>167</sup> Kur identiteti dhe vendbanimi i trashëgimtarëve rezultojnë nga aktet e procedimit. Neni 58 i KDPM-së.

1. Drejtoria përgjegjëse për asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm në Prokurorinë e Përgjithshme (më poshtë, “drejtoria”) përcaktohet në strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe është përgjegjëse për drejtimin e përgjithshëm dhe koordinimin e punës së sektorëve në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm.

2. Kjo drejtori nuk është epror ndaj sektorëve në prokuroritë më të ulta dhe nuk ndërhyt në aspektet procedurale të çështjes dhe në marrëdhënien mes koordinatorit të viktimave dhe prokurorit. Psikologu dhe koordinatori i viktimave janë të detyruar të respektojnë sekretin hetimor edhe përkundrejt këtij sektori.

3. Detyrat e strukturave të kësaj drejtorie janë:

a) harton udhëzime dhe politika për veprimtarinë e sektorëve, përfshirë procedurat standarde të veprimit për kategori të veçanta subjektësh, dhe ia paraqet për miratim Prokurorit të Përgjithshëm;

b) shqyrton praktikën e ndjekura nga sektorët dhe merr masa për unifikimin e tyre, kur është e nevojshme;

c) i raporton Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me veprimtarinë e sektorëve dhe me problematikat që lidhen me asistencën ndaj të pandehurve të mitur, viktimave dhe dëshmitarëve;

ç) vlerëson nevojat për ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe planifikon e organizon programe trajnimi për punonjësit e sektorëve, si edhe bashkëpunon me Këshillin e Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës për trajnimin e prokurorëve për çështje që lidhen me viktimat dhe dëshmitarët;

d) i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm propozime lidhur me personelin e sektorëve, buxhetin e prokurorive, për atë pjesë që ndikon në veprimtarinë e sektorëve, si edhe me legjislacionin për të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve;

dh) harton dhe shpërndan materiale informuese për viktimat e krimit dhe publikun e gjerë. Këto materiale përmbajnë informacion të dobishëm për të drejtat e viktimave të krimit, shërbimet që u ofrohen atyre, si edhe informacione të përgjithshme lidhur me funksionimin e sistemit të drejtësisë penale. Gjithashtu, harton materiale promocionale për punën e sektorëve;

e) krijon hartën e ofruesve të shërbimeve në të gjithë territorin e vendit dhe e vendos në dispozicion të sektorëve dhe të policisë gjyqësore;

ë) krijon dhe ruan kontakte me ofruesit e shërbimeve, strukturat që kanë polici gjyqësore, gjykatat, burgjet dhe shërbimin e provës, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe unifikimin e praktikave të zbatuara për trajnimin e viktimave dhe dëshmitarëve.

## Neni 58

### **Spektori i asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm**

1. Sektori i asistencës ndaj subjekteve me status të posaçëm krijohet në të gjitha prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm. Sektori përbëhet nga të paktën një psikolog dhe një koordinatori i viktimave. Përbërja e sektorit përcaktohet nga drejtuesi i prokurorisë, në përputhje



me nenin 10, paragrafi 2, pika "a" të këtij udhëzimi, brenda burimeve financiare e njerëzore të institucionit.

2. Detyrat e sektorit janë:

a) të japë ndihmën e kërkuar procedurale për të pandehurit dhe viktimat e mitura, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

b) të përmbushë detyrimet e prokurorisë për informacion ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, referimin e viktimave tek ofruesit e shërbimeve dhe garantimin e mundësive për ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre, sipas parashikimeve të ligjit dhe të këtij udhëzimi;

c) të ndihmojë çdo pjesëmarrës në procedim që ka një paaftësi fizike apo mendore për të ushtruar me efektivitet të drejtën për akses në sistemin e drejtësisë penale.

3. Personeli i sektorit i ushtron detyrat e tij pa diskriminim në bazë të moshës, racës, etnisë, gjuhës, fesë, aftësisë së kufizuar, gjinisë, orientimit seksual, statusit martesor, statusit shoqëror dhe ekonomik, bindjeve politike apo mendimit ndryshe.

4. Personeli i sektorit i ushtron detyrat e tij duke patur si objektiv parësor interesin më të lartë të të miturit, parandalimin e viktimizimit të përsëritur dhe riviktimizimit të viktimave të kriminit dhe pakësimin e ndikimit traumatizues të pjesëmarrjes së tyre në procesin penal.

5. Personeli i sektorit i ushtron detyrat konkrete në kundër të një çështjeje nën udhëzimet e prokurorit të çështjes, brenda kufijve të sekretit hetimor.

6. Personeli i sektorit nuk i imponon viktimës gjykimin e vet, përfshirë mendimin e tij lidhur me praninim ose refuzimin e asistencës, nuk i jep viktimës këshilla ligjore dhe nuk i bën premtime lidhur me mënyrën e përfundimit të çështjes apo veprime të caktuara procedurale.

7. Në themel të veprimtarisë së sektorit qëndron trajtimi i të miturve, viktimave dhe pjesëmarrësve të tjerë në proces me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor.

## Neni 59

### **Ndarja e detyrave brenda sektorit**

1. Kur madhësia dhe përbërja e sektorit e lejon, psikologu ushtron vetëm detyrën e parashikuar nga neni 58, paragrafi 2, pika "a" e këtij udhëzimi. Kur kjo ndarje nuk është e mundur, psikologu caktohet për të ushtruar edhe detyra të koordinatorit të viktimave.

2. Kur psikologu ushtron edhe detyra të koordinatorit të viktimave, duhet të bëhet kujdes që ai të mos përfshihet si psikolog dhe koordinator në të njëjtën çështje.

## **KREU VIII DËSHMITARËT**

Neni 60

### **Zbatueshmëria e këtij udhëzimi për dëshmitarët**

Dëshmitari që nuk përfshihet në përkufizimin e “viktimës”, sipas këtij udhëzimi, nuk gëzon të drejtat e parashikuara nga ky udhëzim. Ky udhëzim dhe ligji nuk i detyrojnë prokurorin, punonjësin e policisë gjyqësore dhe personelin e prokurorisë t’u ofrojnë dëshmitarëve të njëjtën asistencë që parashikohet për viktimën, megjithatë ata duhet të bëjnë çfarë është e mundur, pa cënuar të drejtat e të pandehurit, për të ndihmuar dëshmitarin gjatë kontaktit të tij me sistemin e drejtësisë penale, veçanërisht duke zbatuar parimet e neneve 16, 18, 44, 50, 53, 56 të këtij udhëzimi.

## **KREU IX DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 61

### **Kufijtë e përdorimit të këtij udhëzimi**

Ky udhëzim përfaqëson rregulla të brendshme të prokurorisë dhe policisë gjyqësore. Ky udhëzim nuk ka për qëllim krijimin e të drejtave apo të standardeve të sjelljes apo kujdesit, me natyrë materiale apo procedurale, të cilët mund të ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme në rrugë civile apo penale. Ky udhëzim nuk do të interpretohet në mënyra që krijojnë, zgjerojnë ose nënkuptojnë detyra apo detyrime ndaj viktimës, dëshmitarit apo ndonjë personi tjetër, të cilat mund ta bëjnë prokurorinë përgjegjëse nga pikëpamja civile.

Neni 62

### **Zbatimi**

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm<sup>168</sup> për zbatim nga drejtuesit e prokurorive dhe prokurorët<sup>169</sup> e të gjithë niveleve të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe nga oficerët e policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë.

2. Me mbikëqyrjen dhe zbatimin<sup>170</sup> e këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohen drejtoria që mbulon asistencën ndaj subjekteve me status të posaçëm në Prokurorinë e Përgjithshme dhe drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të zakonshëm.

---

<sup>168</sup> Shih nenin 46 pika 1 e ligjit nr.97/2016;

<sup>169</sup> Shih po aty neni 6 pika 2;

<sup>170</sup> Shih po aty nenin 38 pika 2 germa “b”, 42 germa “g”, 43 germa “dh”;

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit<sup>171</sup> të këtij udhëzimi.

Neni 63

### **Modele aktesh**

Pjesë e këtij udhëzimi janë edhe shtojcat e mëposhtme, të cilat përmbajnë modele aktesh:

- a) Shtojca 1: Model i letrës së të drejtave të viktimës;
- b) Shtojca 2: Model i njoftimit të sektorit të asistencës ndaj personave me status të posaçëm;
- c) Shtojca 3: Model i deklaratës për refuzimin e asistencës;
- ç) Shtojca 4: Model i formularit për kërkimin e informacionit;
- d) Shtojca 5: Model i deklaratës së njohjes së përgjegjësisë për mospublikimin e aktit;
- dh) Shtojca 6: Model i deklaratës së dëmit.

Neni 64

### **Hyrja në fuqi dhe publikimi**

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet<sup>172</sup> në faqen e internetit të Prokurorisë Përgjithshme.

## **PROKUROR I PËRGJITHSHËM**



<sup>171</sup> Shih po aty nenin 46 pika 4, etj;

<sup>172</sup> Shih po aty nenin 46 pika 5;

## DËMSHPËRBLIMI NGA I PANDEHURI

Në bazë të ligjit, ju keni të drejtë të kërkonti shpërblimin e dëmit që keni pësuar si pasojë e krimit nga i pandehuri apo personat që përgjigjen për të (p.sh.: prindërit për fëmijën nën 18 vjeç). Shpërblimi i dëmit mund të kërkohet në gjykatën penale, gjatë gjykimit të çështjes penale, ose në mënyrë të veçantë në gjykatën civile. Padia mund të ngrihet për të kërkuar si dëmin material, ashtu edhe jo material.

Është e rëndësishme që të ruani fatura apo të dhëna lidhur me humbje të pësuar apo shpenzime të kryera, që lidhen me krimin: shpenzime mjekësore, funerale, humbja e pagës, dëmtime të pronës, etj. Është po kaq e rëndësishme që padia civile të paraqitet qysh gjatë fazës së hetimit, për t'i lejuar prokurorit që të mbledhë edhe provat që lidhen me shkaktimin e dëmit.

## NDIKIMI EMOCIONAL I KRIMIT

Shumë viktima dhe dëshmitarë të krimeve ndikohen emocionalisht nga kjo përvojë. Çdo person reagon ndryshe, por shumë persona raportojnë reagime të ngjashme, si:

- \* Zemërim;
- \* Ndenjë paniku dhe/ose ankthi;
- \* Makthe dhe ndryshim të ciklit të gjumit;
- \* Ndenjë dyshimi në vetvete, turp ose faj;
- \* Përjetim rishtas të asaj që ka ndodhur;
- \* Depresion, vështirësi në përqendrim;
- \* Shqetesim në rritje për sigurinë personale dhe të familjes.

Shumë njërez vazhdojnë t'i kenë këto reagime edhe pasi ka kaluar kohë nga ngjarja. Ne mund t'ju ndihmojmë për të gjetur shërbimet e duhura mbështetëse dhe ndihmën e duhur për t'i kaluar këto pasoja të krimit.

“Të jesh viktimë në duart e një kriminelit është një makth që nuk harrohet. Po, më pas, të bëhesh viktimë në duart e sistemit të drejtësisë penale është një dështim i pafalshëm. I bën kriminelin dhe sistemin e drejtësisë penale partnerë në krim.”

*Robert Grayson*

## NËSE KËRCËNOHENI

Nëse kërcënoheni apo ndiheni të pasigurt për shkak të bashkëpunimit në hetimin e kësaj çështjeje, ne mund t'ju ndihmojmë. Siguria juaj është shumë e rëndësishme për ne. Ju lutem, kontaktoni menjëherë oficerin që po heton çështjen ose prokurorin. Ata mund të diskutojnë me ju masa sigurie shtesë, si për shembull: urdhër mbrojtjeje, strehim në strehëza, kallëzime të reja penale, dhënien e dëshmisë në distancë, etj.

Nëse jeni dëshmitar, mund t'ju ofrohet edhe një sallë pritjeje të veçantë nga i pandehuri dhe dëshmitarët e tjerë, mbështetje nga personeli i gjykatës dhe informacion e asistencë për shpenzimet që lidhen me paraqitjen në gjyq.



## INFORMACION DHE NDIHMË PËR VIKTIMAT E KRIMIT



*Shtojca nr. 3*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

**DEKLARATË PËR REFUZIMIN E ASISTENCËS NGA VIKTIMA E VEPRËS PENALE**

Në \_\_\_\_\_, më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_.

Plotësohet kjo deklaratë e viktimës për refuzimin e asistencës, lidhur me procedimin penal nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, me të pandehur \_\_\_\_\_, nga

[Emri i viktimës] \_\_\_\_\_

[Përfaqësuesi i viktimës pa zotësi] \_\_\_\_\_

[Emri i koordinatorit ose oficerit që ndihmon në plotësimin e deklaratës] \_\_\_\_\_

**Shënim për viktimën:**

Prokuroria ka detyrimin t'ju njoftojë për të drejtat dhe t'ju ofrojë asistencën e përshkruar në Kodin e Procedurës Penale. Ju nuk jeni të detyruar t'i ushtroni të drejtat tuaja apo ta pranoni këtë asistencë dhe mund të zgjidhni, në çdo fazë të procedimit penal, të refuzoni marrjen e asistencës ose ushtrimin e të drejtave.

Përpara se të nënshkruani këtë deklaratë, duhet të siguroheni që kuptoni rëndësinë dhe pasojat e refuzimit dhe duhet të saktësoni të drejtat dhe asistencën, nga të cilat hiqni dorë.

Pas leximit të udhëzimeve të mësipërme, jap pëlqimin për plotësimin e formularit.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_



1. Jam njohur me të drejtat e mia nëpërmjet letrës së të drejtave të viktimës.

Po  Jo

2. Përmbajtja e të drejtave më është shpjeguar nga:

- Prokurori \_\_\_\_\_
- Oficeri i policisë gjyqësore \_\_\_\_\_
- Koordinator i viktimave \_\_\_\_\_
- Nuk më janë shpjeguar të drejtat

3. Gjatë procedimit penal nr.\_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, me të pandehur \_\_\_\_\_ zgjedh të ushtroj të drejtat e mëposhtme:

*(Shënoni me √ të drejtat që dëshironi të vazhdoni të ushtroni.)*

- Të referohem për kujdes mjekësor.
- Të referohem për ndihmë psikologjike ose këshillim.
- Të referohem për shërbime të tjera. Specifikoni: \_\_\_\_\_

- 
- Të njoftohem për përfundimin e hetimeve.
  - Të njoftohem për pezullimin e hetimeve.
  - Të njoftohem për pushimin e çështjes për kundërvajtje.
  - Të njoftohem për paraqitjen e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes për krime.
  - Të njoftohem për zgjatjen e afatit të hetimit.

Me nënshkrimin e kësaj deklarate pranoj se jam njohur me pasojat e refuzimit të asistencës gjatë procedimit penal dhe se heq dorë prej ushtrimit të të drejtave me vullnet të lirë.

**VIKTIMA**

\_\_\_\_\_

**PËRFAQËSUESI**

\_\_\_\_\_

**PROKURORI**

\_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

*LETRA E TË DREJTAVE TË VIKTIMËS*

**JU KENI TË DREJTË:**

- I. Të përfitoni kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
- II. Të komunikoni në gjuhën tuaj dhe të ndihmoheni nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit në rast se keni aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
- III. Të zgjidhni mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitoni ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;
- IV. Të kërkoni në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njiheni me aktet e provat, pa çënuar parimin e sekretit hetimor;
- V. Të kërkoni marrjen e provave, si dhe të parashtroni kërkesa të tjera përpara organit procedues;
- VI. Të informoheni për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
- VII. Të njoftoheni për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
- VIII. Të bëni ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- IX. Të kërkoni shpërblimin e dëmit dhe të pranoheni si paditës civil në procesin penal;

- X. Të përjashtoheni, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
- XI. Të thirreni në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- XII. Të dëgjoheni nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen tuaj si dëshmitar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

- NORMAL
- PRIORITET (Viktima i përket njërës nga kategoritë vulnerabël).
- URGJENT (Viktima është në gjendje rreziku për jetën).

**KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS  
NJOFTIM PËR ASISTENCËN NDAJ VIKTIMËS**

Në \_\_\_\_\_, më datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_.

Unë \_\_\_\_\_, prokuror, pasi studiova aktet e procedimit penal nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, në ngarkim të të pandehurit: (emër, mbiemër) \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, banues në \_\_\_\_\_, i hetuar nga data \_\_\_\_\_, i akuzuar për veprën penale të \_\_\_\_\_, parashikuar nga neni \_\_\_\_\_ i Kodit Penal, identifikova si viktimë të veprës penale shtetasin/en \_\_\_\_\_, i biri/ebija e \_\_\_\_\_, lindur në \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_, me vendbanim të përhershëm në \_\_\_\_\_, me vendqëndrim të përkohshëm në \_\_\_\_\_ dhe nr. tel. \_\_\_\_\_.

Ju dërgohet ky njoftim me qëllim realizimin e detyrimeve ndaj viktimës së veprës penale që burojnë nga ligji nr.7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe ligji nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Shënime të veçanta:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Mori në dorëzim: \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

*Shtojca nr. 4*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

**FORMULAR PËR KËRKIMIN E INFORMACIONIT NGA VIKTIMA**

Në \_\_\_\_\_, më \_\_/\_\_/\_\_.

Plotësohet kjo kërkesë për informacion, lidhur me procedimin penal nr.\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, me të pandehur \_\_\_\_\_,

nga

[Emri i viktimës] \_\_\_\_\_

[Përfaqësuesi i viktimës pa zotësi] \_\_\_\_\_

[Emri i koordinatorit ose oficerit që ndihmon në plotësimin e deklaratës] \_\_\_\_\_

**Shënim për viktimën:**

Në bazë të nenit 279/a të Kodit të Procedurës Penale, ju keni të drejtën për të kërkuar në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit dhe për t'u njohur me aktet e provat, pa cënuar parimin e sekretit hetimor. Kërkesa mund t'i paraqitet prokurorit me çdo formë nga ju, përfaqësuesi ose mbrojtësi juaj. Ky formular është hartuar për t'ju ndihmuar në paraqitjen e kërkesës për informacion.

Informacioni duhet të kërkohet për t'u përdorur në mënyrë të ligjshme, por ju nuk keni detyrim të tregoni shkakun konkret, për të cilin ju nevojitet informacioni, aktet ose provat dhe as nuk keni detyrim të provoni ekzistencën apo ligjshmërinë e këtij shkakui.

Kërkesa juaj për informacion mund të refuzohet në rastet e parashikuara në ligj. Refuzimi i kërkesës nga ana e prokurorit nuk është i ankimueshëm në gjykatë, por kërkesa e refuzuar mund të paraqitet përsëri pasi të ketë rënë shkakui i refuzimit.

Pas leximit të udhëzimeve të mësipërme, jap pëlqimin për plotësimin e formularit.



**Ju lutemi, plotësoni rubrikat që vlejné për situatën tuaj. Sipas nevojës, përdorni fletë të tjera për të pasqyruar të gjithë detajet e nevojshme.**

1. Kërkesë për informacion mbi statusin e procedimit penal.

Po  Jo

*Nëse dëshironi, jepni më poshtë detaje për shkakun e kërkesës.*

---

---

---

---

---

---

2. Kërkesë për kopje të akteve ose të provave.

Po  Jo

*Nëse po, listoni aktet ose provat, kopjet e të cilave ju nevojiten.*

---

---

---

---

---

---

---

---

*Nëse dëshironi, jepni më poshtë detaje për shkakun e kërkesës..*

---

---

---

---

---

---

---

---

3. Kërkesë për informacion lidhur me masat e sigurimit ndaj të pandehurit.

Po  Jo

*Nëse dëshironi, jepni më poshtë detaje për shkakun e kërkesës..*

---

---

---

---

---

---

---

---

**VIKTIMA**

---

**PËRFAQËSUESI**

---

**PËR T'U PLOTËSUAR NGA PROKURORI:**

(një kopje e kësaj flete i bashkangjitet edhe kërkesës së paraqitur me shkrim)

1. Kërkesë për informacion mbi statusin e procedimit penal.

- Miratuar (*Kalo tek rubrika 1.1*)
- Refuzuar (*Kalo tek rubrika 1.2*)

1.1. Informacioni për statusin e procedimit i është dhënë viktimës

- Me shkrim \_\_\_\_\_
- Me gojë \_\_\_\_\_

1.2. Informacioni për statusin e procedimit refuzohet për shkak se:

- hetimi duhet të mbetet ende i fshehtë dhe rëndësia e këtij fakti është më e madhe se sa rëndësia e shkakut për të cilin viktimja kërkon informacionin;
- ekziston një interes madhor për të ruajtur jetën, sigurinë dhe të drejtat e të pandehurit, veçanërisht të drejtën për proces të rregullt ligjor;
- prokurori nuk ka marrë ende deklaratimet e viktimës dhe është e nevojshme të ruhet viktimja nga ndikimet në kujtesën e saj.

Sqaroni nëse është e mundur në rrethanat e rastit:

---

---

---

---

---

2. Kërkesë për kopje të akteve ose provave.

- Miratuar (*një kopje e kësaj flete i kalon sekretarisë për veprim*)
- Miratuar pjesërisht (*Kalo tek rubrika 2.1*)
- Refuzuar (*Kalo tek rubrika 2.2*)

2.1. Aktet dhe provat që lejohet të merren (*një kopje e kësaj flete i kalon sekretarisë për veprim*)

---

---

---

---

2.2. Aktet dhe provat e kërkuara refuzohen për shkak se:

- hetimi duhet të mbetet ende i fshehtë dhe rëndësia e këtij fakti është më e madhe se sa rëndësia e shkakut për të cilin viktimja kërkon aktin apo provën;

ekziston një interes madhor për të ruajtur jetën, sigurinë dhe të drejtat e të pandehurit, veçanërisht të drejtën për proces të rregullt ligjor;

prokurori nuk ka marrë ende deklaratimet e viktimës dhe është e nevojshme të ruhet viktimja nga ndikimet në kujtesën e saj.

Sqaroni nëse është e mundur në rrethanat e rastit:

---

---

---

---

3. Kërkesë për informacion lidhur me masat e sigurimit ndaj të pandehurit.

Miratuar (*Kalo tek rubrika 3.1*)

Refuzuar (*Kalo tek rubrika 3.2*)

3.1. Informacioni për masat e sigurimit i është dhënë viktimës

Me shkrim \_\_\_\_\_

Me gojë \_\_\_\_\_

3.2. Informacioni për masat e sigurimit refuzohet për shkak se:

dhënia e tij mund të vendosë në rrezik jetën apo shëndetin e të pandehurit.

Sqaroni nëse është e mundur në rrethanat e rastit:

---

---

---

---

Data: \_\_\_\_\_

Prokurori: \_\_\_\_\_

Vendimi i prokurorit iu komunikua viktimës më datë \_\_\_\_\_.

Personi që bëri komunikimin \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Viktima: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

DEKLARATË

PËR RUAJTJEN E SEKRETIT DHE NDALIMIN E PUBLIKIMIT

Në \_\_\_\_\_, më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, ora \_\_\_\_\_.

Unë, \_\_\_\_\_, prokuror, në bazë të neneve 103, 105/3 dhe 279 të Kodit të Procedurës Penale dhe në zbatim të vendimit nr.\_\_\_\_, datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_”Për ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimit” marr këtë deklaratë për ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimit të akteve sekret ose të akteve të hetimit që ndalohet publikimi i tyre, nga Z. \_\_\_\_\_ [funksioni ose lidhja që ka me procedimin].

Aktet procedurale me të cilat është njohur ose që i janë lëshuar kopje, estrakte ose vertetime deklaruesit janë:

\_\_\_\_\_  
[Shënohet akti/et, klasifikimi nëse është i klasifikuar, numri i faqeve, e të dhëna të tjera që vlerësohen të nevojshme për tu pasqyruar në deklaratë]

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

*Shtojca nr. 6*



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

---

**DEKLARATË E DËMIT**

Në \_\_\_\_\_, më \_\_/\_\_/\_\_.

Plotësohet kjo deklaratë mbi dëmin e pësuar nga vepra penale, lidhur me procedimin penal nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, me të pandehur \_\_\_\_\_,

nga

[Emri i viktimës] \_\_\_\_\_

[Përfaqësuesi i viktimës pa zotësi] \_\_\_\_\_

[Emri i koordinatorit ose oficerit që ndihmon në plotësimin e deklaratës]

---



**Shënim për viktimën:**

Në bazë të nenit 61 të Kodit të Procedurës Penale, ju keni të drejtë të paraqisni padi civile në procesin penal. Kjo deklaratë ju ndihmon të përgatiteni për paraqitjen e padisë civile dhe, gjithashtu, ndihmon prokurorin të mbledhë prova të nevojshme për çështjen penale. Për paraqitjen e padisë civile, ju mund të konsultoheni me një avokat. Koordinatorin e viktimave dhe, në mungesë të tij, oficerin e policisë mund t'ju ndihmojnë për plotësimin e këtij formulari.

Ju duhet të keni parasysh se plotësimi i kësaj deklarate nuk është i detyrueshëm. Mosplotësimi i kësaj deklarate nuk sjell pasoja ligjore për ju. Plotësimi i saj nuk ju pengon të paraqisni padi civile, e cila mund të përmbajë kërkime të ndryshme nga kjo deklaratë.

Pas leximit të udhëzimeve të mësipërme, jap pëlqimin për plotësimin e formularit.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

**Ju lutemi, plotësoni rubrikat që vlejnë për situatën tuaj. Sipas nevojës, përdorni fletë të tjera për të pasqyruar të gjithë detajet e nevojshme.**

**(Ju lutemi, bashkëngjitni faturat që dispononi dhe çdo dokument tjetër që mund të provojë deklaratimet tuaja.)**

1. A keni pësuar dëmtime fizike, si rezultat i veprës penale?

Po  Jo

*Nëse po, përshkruani dëmtimin që keni pësuar.*

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

2. A keni marrë trajtim mjekësor për dëmtimet e shkaktuara nga vepra penale?

Po  Jo

*Nëse po, përshkruani trajtimin e marrë.*

---

---

---

---

---

---

---

---

---

3. Sa kanë qenë shpenzimet e trajtimit mjekësor? \_\_\_\_\_

4. A keni sigurim shëndetësor shtetëror apo privat? Po  Jo

5. Nëse po, a është mbuluar ndonjë pjesë e shpenzimeve nga agjencia apo kompania e sigurimeve?  
*Shpjegoni, nëse është e nevojshme.* Po  Jo

---

---

---

---

---

---

---

---

6. A u është dëmtuar apo vjedhur ndonjë send si rezultat i veprës penale? Po  Jo   
*Nëse po, listoni dhe përshkruani këto sende dhe vlerën e tyre.*

---

---

---

---

---

---

---

---

7. A keni fitime të munguara, si pasojë e veprës penale? Po  Jo   
*Nëse po, saktësoni dhe shpjegoni.*

Numri i ditëve që keni munguar në punë \_\_\_\_\_ dhe të ardhurat e pakësuara për shkak të mungesës \_\_\_\_\_.

Fitimi i munguar në shumën \_\_\_\_\_, si pasojë e \_\_\_\_\_

---

---

---

---

---

6. A jeni kompensuar në ndonjë mënyrë për dëmtimet/humbjet e shkaktuara nga vepra penale?

*Nëse po, plotësoni të dhënat.*

Po  Jo

Emri i personit/kompanisë \_\_\_\_\_

Shuma e parave të paguara \_\_\_\_\_

Arsyeja \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

7. A keni pësuar ndonjë dëm tjetër material, si pasojë e veprës penale?

Po  Jo

*(Nëse po, përshkruani.*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**VIKTIMA**

\_\_\_\_\_

**PËRFAQËSUESI**

\_\_\_\_\_